

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 03.04.2023*

03.04.2023

Ora 10:30

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 43.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 03 prill 2023 ora 10:30 zhvillojmë seancën e shortit për caktimin e relatorit, kërkesë ankimore numër 43, me ankues Eduart Nallbani i cili ankimon vendimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 220, datë 30.03.2023, referuar nenit 14 rregullores së KAS-it kemi përgatitur 5 shirita letre ku në njërin kemi shënuar vendimin e kërkesës ankimore numër 43, shiritat e tjerë janë të bardha dhe pa shënime. Shiritat e letrës palosen nga një përfaqësues i KQZ-së, dhe hidhen në një gotë, vendosen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it të pranishëm kanë autorizuar përfaqësues të KQZ-së t’i tërheqi në emër dhe për llogari të tyre goglat. Shorti do të vijoi me rendin alfabetik rritës duke filluar nga zoti Ervin Lako. Pasi janë 5 gogla në një enë transparente përzihen nga përfaqësues i KQZ-së.

- Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa - kërkesa ankimore numër 43.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

1

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 03.04.2023*

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit për kërkesën ankimore numër 43 është caktuar relator zoti Elvis Çefa, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

P. Hecely

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

3.04.2023
Ora 10:37

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 42, datë 31.03.2023, të Partisë Socialiste, me objekt “ 1. Ndryshimin e vendimit nr. 31, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 90, Sarandë dhe 2. Mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z. Gjergj Filip Mërkuri”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Të tjerë: Z. Gjergji Mërkuri, Z. Maringlen Legisi

Z. L. Braho: Mirmëngjes! Çelim seancën për shqyrtimin e verifikimin për plotësimin e formës dhe të përmbajtjes së kërkesë ankimore numër 42, depozituar në KQZ në datë 31 Mars 2023, me ankues subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, pasi është depozituar kërkesa ankimore, në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe rregullores së funksionimit të KAS- it kërkesa është hedhur në short dhe nga shorti më ka rënë mua anëtarit Ledio Braho për të relatuar i kësaj kërkesë ankimore. Objekti i ankimimit të saj ka të bëjë me vendimin numër 31 të datës 28 Mars 2023, të KZAZ numër 90 Sarandë dhe objekt ankimi është ndryshimi i këtij vendimi dhe mos regjistrimi i këtij kandidati për kryetar të njësisë për qeverisjen vendore z. Gjergji Filip Mërkuri që është subjekt zgjedhor, është regjistruar në cilësinë e subjekti zgjedhor propozuar nga një grup zgjedhësi. Në këtë seance do të shqyrtojmë vetëm me elementët që kanë të bëjnë me kompetencën e KAS për shqyrtimin e këtij ankimi, legjitimitimin e ankuesit dhe respektimin e afateve ligjore për ankimin. Atëherë ju lutem të identifikohen palët që janë të pranishme, për ankimuesin?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

Z. M. Legisi: Pwr ankimues avokat Mariglen Legisi përfaqësues me autorizim i nderuar.

Z. L. Braho: Po, faleminderit! Palë të tjera?

Z. Gj. Mërkuri: Përfaqësues Gjergj Mërkuri, kandidat i pavarur subjekt, me përfaqësues Gentian Muço pwrfaqwsues ligjor.

Z. L. Braho: Ok, avokatin e keni me deklaram besoj?

Z. Gj. Mërkuri: Po me deklaram.

Z. L. Braho: Ok, faleminderit! I pranishëm gjithashtu është edhe përfaqësuesi i KQZ Sekretar i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Atëherë me pak fjalë z. Merkaj në lidhje me qëndrimin e KQZ për këtë kërkesë ankimore, përse i përket elementëve të formës dhe përmbajtjes.

Z. K. Bele: KZAZ-ja është njoftuar.

Z. Y. Merkaj: Është njoftuar dhe ka kthyer përgjigje me email, thotë që nuk mund të vijmë dot dhe kanë dhënë shpjegime.

Z. L. Braho: Po shoh që ka sjell edhe një qëndrim, që është i datës 3 Mars 2023 dhe është firmosur me sa shikoj vetëm nga Sekretarja e KZAZ. E konfirmoni këtë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

qëndrim për të gjithë anëtarët e KZAZ, pra janë dakord të gjithë anëtarët e KZAZ?
Dakord, mirë, vazhdo z. Merkaj

Z. Y. Merkaj: Emaili ishte i datës 3 Prill, jo 3 Mars.

Z. L. Braho: Dakord!

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 42, me ankues subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë e cila ankimon vendimin nr. 31 datë 28.3.2023 të KZAZ nr.90, Sarandë e cila ka vendosur regjistrimin si kandidat për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z. Gjergji Merkuri. Ankuesi ka pretenduar se kandidati është regjistruar në bazë të nënshkrimeve të fallcifikuara, kandidati është regjistruar në bazë të nënshkrimeve të personave të cilët nuk e kanë vendbanimin Sarandë, si dhe në bazë të nënshkrimeve në bazë të personave, të cilët nuk kanë ditur qëndrimet për të cilat kanë nënshkruar. Duke parë elementët e formës dhe të përmbajtjes, kërkesa ankimore, konstatohet se është në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, pasi plotëson tre elementët, si kompetencë e KQZ-së, në rastin konkret të KAS-it për ta shqyrtuar vendimet e KZAZ-së, legjitimi i ankuesit, i cili legjitimohet në këtë procedurë administrative, si dhe respektimi i afateve, është bërë ankimi brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Ju faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Fjala për ankimesin në lidhje me këto tre element, zoti Legisi.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

Z. M. Legisi: Faleminderit zoti kryetar! Edhe në vlerësimin tonë, ne shohim që kërkesa është depozituar brënda afateve ligjore, shoqëruar me prova, po ashtu edhe në lidhje me legjetimimin, ne vlerësojmë që si subjekt zgjedhor që ka një kandidat në Bashkinë e Sarandës dhe që ka marr pjesë gjatë verifikimit të nënshkrimeve, procedurë e realizuar nga KZAZ-ja, kemi konstatuar parregullsi në mbledhjen e nënshkrimeve nga kandidati, dhe i janë reklamuar këto parregullsi KZAZ-së. Pra, në mënyrë të përmbledhur, i kemi reklamuar KZAZ-së, që mbledhja e nënshkrimeve është bërë në kundërshtim me ligjin, dhe në këtë kuptim, nuk është një vullnet që e njeh ligji, mbi bazën e të cilit i jep të drejtë kandidatit për tu njohur si subjekt zgjedhor, dhe nuk duhet të ishte regjistruar. Vlerësojmë që ne legjitimohemi në lidhje me këtë pikë. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po faleminderit! Përpara se të vazhdojmë me subjektin, unë nga vendimi i KZAZ-së shoh që nuk ju nuk keni qënë, ose më saktë, Partia Socialiste nuk ka qënë e pranishme në momentin e seancës publike, KZAZ-ja pretendon që ju ka njoftuar dhe ato nuk kanë qënë të pranishëm, si Partia Socialiste, si përfaqësues të koalicionit Bashkë Fitojmë, kështu që mund të na e sqaroni kur ka qënë momenti që ju i keni reklamuar këto pasaktësi në mbledhjen e nënshkrimeve, sipas jush?

Z. M. Legisi: Janë depozituar me shkresa zoti kryetar, janë dy shkresa, shkresa parë me numër protokoll 46, datë 28.03.2023, dhe shkresa me protokoll numër 42, datë 28.03.2023. I janë vënë në dispozicion KZAZ-së, dhe është dhënë një listë emërore të personave që kanë pretenduar dhe janë ankuar pranë strukturave të Partisë Socialiste në qytet, që nënshkrimet na janë marrë duke na u prezantuar një situatë tjetër e faktit, pra që këto nënshkrime i kemi dhënë në kuadër të një gare të kandidatit brënda Partisë Socialiste, me qëllim kandidimin e tij përfundimtar, në zgjedhjet

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

vendore. Në kushtet kur ata e kanë marr dijeninë nëpërmjet mediave apo edhe nga komunikimi me njëri- tjetrin, sepse Saranda është qytet i vogël, që këto nënshkrime kanë qënë marr në kuadër të një kandidimi të pavarur, atëhere ata edhe janë paraqitur edhe janë ftuar pranë strukturave vendore të Partisë Socialiste, për të nënshkruar disa deklarata, meqënëse ishte i njëjtë problem, kanë nënshkruar disa deklarata, të cilat ne i kemi paraqitur, pra që ne nuk kemi patur vullnet që ky kandidat të dalë si i pavarur. Po ashtu kemi edhe deklarata të personave që nuk pranojnë që nënshkrimi është i tyre, dhe ka persona në listë që njihen prej vitesh që nuk banojnë, nuk jetojnë më në Sarandë, dhe këto janë vënë në dispozicion të KZAZ-së, me këto shkresa, me numër protokolli. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, dhe fjala për subjektin për të cilin kërkohet çregjistrimi.

Z. G. Muço: Po faleminderit! Në lidhje me elementët e ankimit, do të ndalesh pak te afati, konstatojmë që vendimi nga KZAZ, numër 90, është shpallur në orën 17.00, të datës 28 mars 2023, të pranishëm kanë qënë edhe përfaqësues të subjektit politik Partia Socialiste, kurse ankimi kundër këtij vendimi është depozituar në orën 18.30, të datës 31 mars 2023, me numrin protokoll përkatës. Ky afat kohor nga ora 17.00, e datës 28 mars deri në orën 18.30, të datës 31 mars 2023, e konstatojmë si në shkelje të nenit 125, paragrafi i parë, mosrespektimi i afatit prej 72 orësh. Ky fat ka skaduar në orën 17.00 të datës 31 mars 2023, dhe ankimi i depozituar një orë e gjysmë me vonesë, pra në orën 18.30, sjell që ky ankim mos të merret në shqyrtim nga organi proçedues, kurse për aspekte të tjera të themelit do mbajmë qëndrim më pas. Tani kërkojmë, në këtë pjesë të shqyrtimit, mospranimin e ankimit, për shkelje të afatit parashkruar neni 125 dhe neni 70, pika 3, në lidhje me kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së, në këtë moment proçedural. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

Z. L. Braho: Për legjitiminin keni ndonjë?

Z. G. Muço: Jo nuk kemi. Për të qënë ekonimik u përqëndrova vetëm te pjesa e afatit.

Z. L. Braho: Mirë, faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Po zoti ...

Z. I. Rusmali: Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e ankuesit, dhe e kam për legjitiminin. Cili është interesi i ligjshëm i juaj që ju gjykoni që ju çënohet nga regjistrimi i subjektit tjetër?

Z. M. Legisi: Faleminderit i nderuar! Cënimi i interes të ligjshëm, jemi në një garë zgjedhore dhe sigurisht që ne na intereson që të gjithë garuesit, të jenë në garë dhe të futen në garë, dhe të kalojnë filtra që çdo subjekt i ka kaluar, dhe i kalon ato filtra. Pra, dhe këto i përcakton mjaft qartë ligji. Në momentin që ne vëmë re dhe konstatojmë që regjistrimi i një kandidati, i një subjekti zgjedhor është bërë në kundërshtim me ligjin, që këtu vërehet pabarazia. Në këtë kuptim ne e kemi si interes ligjor të ligjshëm, dhe që jemi pjesëmarrës pra në këtë zonë, ku regjistrimi i kandidatit në kundërshtim me ligjin na legjitimon ne i nderuar ky është legjitimimi, ky është edhe pretendimi, është një vendim që ankimohet. Pra vendimi që regjistrimin e subjektit apo dhe mosregjistrimi është një vendim i ankimueshëm. Ne sigurisht që e dimë që në zgjedhje mund të marrin pjesë, dhe kanë të drejtë që të marrin pjesë më shumë se një subjekt, pra ne nuk hymë në zgjedhje, Partia Socialiste nuk hyn në zgjedhje me mendimin që do jetë ajo forca e vetme politike garuese në këto zgjedhje, janë dhe të tjerë. Por sigurisht që ligji ka parashikuar filtra, dhe nëse

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

këto filtra kalohen duke shkelur normat dhe procedurat, atëherë ne vlerësojmë që këtu ka pabarazi, dhe në këtë moment lind interesi në mënyrë automatike. Pra një kandidat që kandidon, që është i zgjedhur, është i regjistruar në zgjedhje në kundërshtim me ligjin, i jep legjitimitet kujtdo që është pjesëmarrës në këtë garë që ta kundërshtojë këtë regjistrim. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po, zoti Çefa keni pyetje?

Z. E. Çefa: Përsëri kam një pyetje për palën ankuese. Nuk e di nëse jeni në dijeni të praktikës së Kolegjit Zgjedhor, përsa i përket legjitimitetit në kundërshtimet e ndërsjellta përsa i përket regjistrimit si subjekte zgjedhore.

Z. M. Legisi: Po, patjetër që jemi edhe përgjigjia që dhashë e kishte në konsideratë atë vendim, kam parasysh një vendim të 2019 të Kolegjit, në lidhje me Partinë “Bindja Demokratike”, në mos gaboj, dhe besoj e përfshim edhe atë. Pra fakti që një... Dhe mendoj, prapë që të mos e përsëris, regjistrimi i një kandidati në kundërshtim me ligjin legjitimon automatikisht palët e tjera që do të ankimojnë këtë vendim, ndryshe nuk do zhvillohet asnjëherë praktika, apo rrezikojmë situata që nuk janë aspak serioze për procesin zgjedhor. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Dakord, këtë vendim të Kolegjit që cituat , e keni, e dispononi aktualisht?

Z. M. Legisi: Jo, për momentin nuk e kam, faleminderit!

Z. E. Çefa: Mirë, dakord, faleminderit! Nuk kam pyetje të tjera.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.3.04.2023

Z. K. Bele: E kisha më shumë për Yllin, pak a shumë është e njëjta pyetje sepse nuk e kam shumë specifike por e kam dhe pak në lidhje me qëndrimin e KQZ-së. Po mundohem ta gjej dhe ta lexoja vendimin e Kolegjit, por pak a shumë ne ja dimë tekstin, diku e kam këtu. Çështja është Ylli a duhet të konsideroni vendimet e Kolegjit janë detyruese për ju, ose a duhet të reflktohen në vendimmarrjen tuaj? Kur kolegji thotë pak a shumë, që një subjekt nuk ka interes të ligjshëm për regjistrimin apo jo të një kandidati apo subjekti tjetër.

Z. Y. Merkaj: Patjetër që janë të detyrueshme për KQZ-në.

Z. K. Bele: Po në raport me këtë çështje?

Z. Y. Merkaj: Nuk e di, nuk i kam këtu vendimet e Kolegjit.

Z. K. Bele: Sepse është vendim i 2019 për Bindjen Demokratike...

Z. L. Braho: Vendimi nr 12, datë 24.06.2019, ku paditës është Partia e Unitetit Kombëtar apo nuk është kjo...jo është tjetër kjo, është tjetër. Ja do ta gjejmë dhe do ta citojmë.

Z. E. Lako: Ta bëj dhe unë një pyetje sa ta gjeni ju atë? Për përfaqësuesin e ankuesit, një pyetje, KZAZ-ja ka marrë me shumicë apo unanim këtë vendim për regjistrimin, dhe subjekti juaj a ka përfaqësues në KZAZ, dhe si kanë votuar në këtë rast ato? Megjithëse ju pretendoni se ne e kemi kundërshtuar për...

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

Z. M. Legisi: Po, faleminderit! Në dijenin time vendimi ka qënë unanimit, pra për regjistrimin e kandidatit. Faleminderit!

Z. Y. Merkaç: Janë shtatë ata, por njëri nga anëtarët e KZAZ-së ka dhënë dorëheqjen për shkak të kandidimit si anëtar.

Z. K. Bele: Nga praktika rezultojnë gjashtë këtu, e kam korrekte?

Z. E. Çefa: Atëhere është vendimi i Kolegjit numër 1, datë 9 maj 2019, me paditës Partia Bashkimi Demokrat Shqipëtar, i paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe me objekt kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, numër 230 viti 2019, për regjistrimin e subjektit Bindja Demokratike, dhe Kolegji Zgjedhor e ka rrëzuar këtë kërkesë padi, duke argumentuar pikërisht faktin e moslegjitimitimit të subjektit paditës, për të kundërshtuar regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor. Avokat, faleminderit!

Z. L. Braho: Nëqoftëse nuk ka pyetje të tjera, atëhere Kas do tërhiqet për vendim në lidhje me verifikimin e kushteve të përmbajtjes dhe të formës, dhe për 15 minuta prisni këtu, 15 minuta, 20 minuta sa të shpallet vendimi lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

Përshëndetje dhe një herë, atëhere KAS pasi u tërhoq për të marr vendimin, në zbatim në lidhje me kërkesën ankimore numër 42 të datës 31 mars 2023, në zbatim të nenit 129, pika 3, shkronja b, të Kodit Zgjedhor.

Vendosi: Mospranimin e kësaj kërkesë ankimore, për shkak të mungesës së një nga elementët e përcaktuar, që është në nenin 130, dhe që ka të bëjë pikërisht me legjitimitetin.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.3.04.2023*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve, në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. U shpall sot në datë 3 prill 2023.
Seanca deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr. 40

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

03.04.2023

Ora 11:05

RENDI I DITËS

Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.43, subjekti ankues zoti

Eduart Nallbani.


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirdita të gjithëve, shpallim të hapur seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore numër 43 të datës 1 prill 2023, me ankues zotin Eduart Muhamet Nallbani me cilësinë e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë i propozuar nga zgjedhësit i cili kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 220 datë 30 mars 2023. Duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe duke vendosur regjistrimin e ankimuesit si kandidat për anëtar të këshillit bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Sipas shortit të hedhur në KQZ relator i kësaj kërkesë ankimore jam caktuar unë, Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, nuk është prezent ankimuesi. Kërkesa paraprake nëse ka nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Jo!

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. Elvis Çefa: Nuk ka! Atëhere nuk kemi pengesë për të vazhduar me relatimin shkurtimisht nga Sekretari i Përgjithshëm i elementëve formal të ankimit. Zoti Merkaj për ju fjala!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 43, nga ankuesi Eduart Nallbani në cilësinë e kandidatit për anëtarë të Këshillit të bashkisë, Tiranë i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. I cili kundërshton vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numër 220 datë 30.03.2023. Nga verifikimi i elementëve formal të kërkesës ankimore konstatohet se është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor dhe si e tille duhet të propozohet të kalohet në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. K. Bele: Ky ankim nuk ka një shkak të mundshëm të parimit, me pamje të parë. Sepse ne verifikojmë me pamje të parë. Ky thotë në ankim... ligjërisht... çfarë ngre ky?! Paragrafi i cituar nuk është për kandidat për anëtar të këshillit bashkiak.

Z. L. Braho: Jo, sepse shiko çfarë thotë, 70 pika 3 thotë komiteti mund të regjistrojë një kandidat për Kryetar të Bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidat...

Z. K. Bele: Ka bërë një arsyetim se kush është shkelja ligjore. Të thuash që nuk është ky nen, është ai nen nuk duhet të ketë një formë ligjore ankimi. Përveç në themel por nuk po e paragjykojmë themelin. Por ky duhet të arsyetojë që vendimi i Komisionerit që thotë 7,000 dhe janë 1,900 është në kundërshtim me nenin kaq. S'është neni 3 por është neni 4! Këtu e kisha dhe për këtë diskutim.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. E. Çefa: Atëhere, KAS-i i konsultuar në vend pasi të vlerësojë elementët formalë me të gjithë mangësitë dhe paqartësitë në ankimin e subjektit vendosi që ta kalojë çështjen për shqyrtim në seancë themeli e cila do të zhvillohet nesër, ditën e martë në datën 4 prill ora 12:00. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 41

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



03.04.2023
Ora 11:22

RENDI I DITËS

*Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 41, datë 31.03.2023, të Partisë
Aleanca e Maqedonasve per Integrimin European, me objekt "Kërkesë për
regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak
në bashkinë Pustec, qarku Korçë, të Partisë Aleanca e Maqedonasve për
Integrim European".*

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike** AMIE (V. Sterjovski)
- **Të tjerë** Përfaqësues të KZAZ-së nr. 71, Bashkia Pustec
(J. Nikolla, N. Nokollovski), anëtarë të KZAZ-së.

Z. E. Çefa: Mirëdita atëherë, çelim seancën e shqyrtimit të Kërkesës Ankimore nr. 41, me subjekt kërkesë partinë "Aleanca e Maqedonasve per Integrimin European". Relator i kësaj kërkesë jam unë Elvis Çefa. Verifikojmë pjesëmarrjen. Është në prezencë të plotë trupa e KAS-it. Është prezent përfaqësuesi i ankimuesit. Ju lutem prezantohuni.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Vasil Sterjovski, kryetar i partisë "Aleanca e Maqedonasve per Integrimin European".

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Janë prezent gjithashtu përfaqësues apo anëtarët e KZAZ-së nr. 71 në Bashkinë Pustec. Ju lutem prezantohuni shkurtimisht, vetëm emrat.

Përfaqësuesit e KZAZ-së nr.71, Pustec: Jani Nikolla, sekretar i KZAZ-së nr. 71 në Bashkinë Pustec, Niko Nokollovski nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, (*nuk kuptohet qartë emri*) anëtar i KZAZ-së nr. 71, Vangjel (*nuk kuptohet qartë mbiemri*) anëtar i KZAZ-së nr. 71, Nikoleta (*nuk kuptohet qartë mbiemri*) anëtar i KZAZ-së nr. 71.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Është prezent gjithashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e tij. Sipas procedurës tani do ia japim fjalën shkurtimisht Sekretarit të Përgjithshëm për të na parashtruar edhe njëherë kërkesat në ankim dhe pastaj do ia japim fjalën palëve.

Z.Y. Merhaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 41, me ankues partia “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” e cila ankimon vendimin ose detyrimin e KZAZ-së nr. 71, për të marrë vendim për regjistrimin e listave shumemërore për anëtar të këshillit bashkiak të Bashkisë Pustec. Në arsyetimin e ankimit pala ankuese arsyeton se pas ndërhyrjeve politike kanë refuzuar pranimin e dokumentacionit të partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” pa dhënë asnjë shkak se pse KZAZ-ja nr. 71 nuk e ka regjistruar. Thotë thjesht dhe vetëm për arsye politike. Ndërkohë nga shpjegimet e KZAZ-së konkludojmë se kjo parti, “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” nuk ka sjellë dokumentet sipas nenit 77, të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. E. Çefa: Faleminderit, Atëherë përfaqësuesi i ankuesit, cili nga ju do të flasë? E keni fjalën ju.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Faleminderit! Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ankimi ynë siç u përmend këtu ka të bëjë me kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec, Qarku Korçë nga partia “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian”. Në datën 27.03.2023, në orën 23:55 kemi qenë në shkollën e mesme në Pustec, ku është vendosur KZAZ-ja nr.71. Në cilësinë e kryetarit të partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian” jam paraqitur pranë KZAZ-së nr.71 në Pustec për të dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm si dhe listën shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec. Anëtarët e KZAZ-së nr.71 kanë filluar të shqyrtojnë dokumentacionin e kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec. Gjatë kohës që kam qenë në ambjentet e KZAZ-së kandidati i opozitës për kryetar në Bashkinë Pustec ka marrë në telefon anëtarin e Partisë së Lirisë, por edhe sekretarin e KZAZ-së duke i kërkuar që të mos vazhdojnë me shqyrtimin e dokumentacionit, të mos pranojnë lisat e partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian”. Më vonë një anëtar i KZAZ-së së bashku me sekretarin kanë dalë nga ambjentet e KZAZ-së. Nuk e di çfarë anë diskutuar por pasi janë kthyer, kanë vendosur që kanë qenë pro që ti marrin dokumentat, që do të vazhdohet me shqyrtimin e dokumentave. Dy anëtar kanë qenë kundër dhe më kanë thënë që ditën e nesërme, në atën 28.03.2023 do të diskutonin me KQZ-në...me dokumentacionin e KQZ-së dhe kanë mbajtur në procesverbal, sekretari e ka mbajtur një procesverbal. Pasi e kam parë, kam reaguar për të dhënat, pasi atje shënonte të dhënat orën 00:15 që kam qenë prezent, në fakt kam qenë prezent në

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

orën 23:55, si dhe që ka mungesë dokumentacioni dhe kam fiksuar faktin që nga mungesa e dokumentacionit, mungonte vetëm një fotokopje karte identiteti të një kandidati, kartë të cilën e kam patur në telefon dhe ja kam treguar dhe i jam lutur që nëse ka mundësi ta printojmë brenda zyrave të ambjenteve të KZAZ-së. Më kanë thënë që nuk punon printer. I kam thënë që në bazë të Kodit Zgjedhor ka afat dy ditë që të bëj plotësimin e dokumentave, por më kanë thënë që do të komunikojmë ditën tjetër pasi të flasim me KQZ-në. Ditën e nesërme në datën 28.03.2023 sekretari i KZAZ-së më ka marrë në telefon që ka komunikuar me KQZ-në dhe nga ana e përfaqësuesve të KQZ-së i kanë thënë që ti marrë dokumentat e partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian” dhe të firmosin të katër anëtarët. Ju vë në dijeni se KZAZ-ja e Pustecit nuk ka 7 anëtarë siç parashikon ligji, sepse Partia Demokratike nuk ka depozituar anëtarët e saj në KZAZ dhe për këtë nevojë duhet të firmosnin të katër anëtarët procesverbalin e marrjes së dokumentave dhe sekretari i KZAZ-së më ka thënë që ti çoja dokumentet në KZAZ. Përpara se ti çoja, të flisja edhe me anëtarin e Patisë së Lirisë që edhe ai të firmoste dokumentat, kam folur me kryetarin e Patisë së Lirisë, sepse ai më ka thënë që për gjysëm ore do të më marrë në telefon sepse ka një punë. Pasi kemi folur përsëri për gjysëm ore, më ka thënë që është konsultuar me Partinë e Lirisë dhe ata i kanë thënë kategorikisht të mos i firmosin dokumentet e partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian” dhe do të mbajë përgjegjësi ligjore. Më është lutur që nuk është faji i tij sepse a ka të ardhmen... ai do të lëvizë jashtë shteti dhe nuk do të krijojë probleme të tilla dhe prandaj nuk do ta firmosë listën e partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian” dhe duke u ndodhur në këto fakte brenda ditës, në datën 28 kemi ardhur në Tiranë dhe kemi depozituar gjithë dokumentacionin, listën shumemërore, si dhe kërkesën

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

ankimore për pranimin e listës së partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” për Bashkinë Pustec, faleminderit.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë, përfaqësuesit e KZAZ-së doni të flisni apo ta ndërtojme në formë pyetjesh debatin. Si e keni më mirë për ju?

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Për sa i përket procesit që na keni thirrur, ne si KZAZ nr. 71, atë ditë kemi punuar sipas Kodit Zgjedhor. Që në orën 09:00 zyra e KZAZ-së ka qenë hapur deri në orën 00:05 min të datës 28.03.2023. Gjatë ditës kemi pritur pesë subjekte politike dhe dy kandidatura për kandidat në Këshillin Bashkiak. Procesi ka vazhduar normalisht deri në orën 22:00, kur dosjet me listat shumëmemërore dhe dosjet e kandidatëve janë shqyrtuar nga aëtarët e KZAZ-së dhe kanë marrë vendimet përkatëse, të cilat janë sjellë në Komision Qendror të Zgjedhjeve. Për sa i përket pretendimit të Partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” ju sqaroj se zotëria në fjalë, kryetar i partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” Është telefonuar pas orës 22:00 mbi 20 herë me telefon nga ana e Sekretarit të KZAZ-së. Telefoni i zotërisë ka qenë i padisponueshëm me pretendimin se ka qenë në Maqedoni. Zotëria në orën 00:05... KZAZ-ja duke parë që nuk kishte asnjë përfaqësues që priste në rradhë për regjistrim, ka vendosur që të mbyllë procesin e regjistrimit të subjekteve politike. Në orën 00:18 jam telefonuar nga sekretari i KZAZ-së sepse më njoftoi që ka ardhur përfaqësuesi i partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European”. Unë në cilësinë e nënkryetarit, me dëshirën e mirë për ta regjistruar subjektin në fjalë, kam lajmëruar në orën 00:40 anëtarët e tjerë të KZAZ-së. Kanë ardhur jashtë ambjenteve të KZAZ-së anëtarët. Kemi diskutuar dhe nuk kemi gjetur konsensus të plotë për regjistrimin e subjektit. Megjithatë në këto rrethana kemi hapur edhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

njëherë zyrat e KZAZ-së me arsyetimin se kryetari i partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European” kishte dosje të kompletuar. I kemi thënë zotërisë të nxirrte listën shumemërore fillimisht. Ai na ka nxjerrë një fletë të bardhë e na ka thënë më jepni një sitirolaps të plotësoj listën e shumë emrave. Në këtë moment anëtarët nuk kanë rënë dakord dhe kanë thënë që ne do të ikim sepse nuk rrimë dot deri në orën 02:00 të mëngjesit. Mblodhëm dokumentacionin dhe vendosëm mosregjistrimin e subjektit. Ky është fakti, thjesht realiteti, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit!

Z. J. Nikolla, sekretar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Pavarësisht pretendimeve të kryetarit partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European”, ne të gjitha edhe telefonatat edhe filmimet me video i kemi të faktuara. I kemi edhe me vete dhe mund ti tregojmë edhe në çfarë ore ka arritur, që pretendon në 23:55. Në orën 00:18 ka hipur në makinën time se binte shi. E kam marrë unë, në prezencën e tij i kam telefonuar dhe anëtarët e tjerë që ishin larguar, me dëshirën e mirë për ta regjistruar. Ai është paraqitur pa dokumentacionet përkatëse. Me listën shumemërore bosh dhe më ka kërkuar stirolaps që ta plotësonte atje. Anëtarët e tjerë nuk kanë qenë dakord. Kemi zbatuar të gjitha urdhrat e KQZ-së për të punuar dhe për të pritur të gjitha subjektet dhe kandidatët për kryetar bashkie. Pas orës 00:00 kemi mbyllur zyrën. Kemi marrë edhe KQZ-në në telefon, disa numra nuk na janë përgjigjur, për të marrë edhe mendimin dhe anëtarët kanë marrë vendim për mospranimin e dokumentacionit. Nëse do të kishte listat shumemërore të plotësuara, ne me gjithë dëshirën e mirë do ja kishim marrë dhe do i kishim lënë afat për ti plotësuar. Ai është paraqitur dhe me kartën e identitetit në telefon. Kishte tre jave, një muaj përpara kohë që ti plotësonte dhe të sillte

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

dokumentacionin, jo të priste momentine fundit, të paraqitej në KZAZ në orën 00:20 min për tu regjistruar. Kaq kisha unë.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit!

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Faleminderit! Unë jam dakord që nëse kanë video dhe foto me orën që pretendojnë, ta shfaqin këtu, ta shikoni dhe ju që ka qenë ora 00:20, jam dakord që ta shfaqin para jush që kjo nuk ka qenë e vërtetë. E gjitha siç e kam relatuar edhe në kërkesën ankimore ka qenë. Dua të theksoj faktin që ne jemi një bashkim minoritar, maqedonase. Ne jemi e vetmja parti (*nuk kuptohet*) që në statutin e saj në Gjykatën e Tiranës ka në thelbin e saj mbrojtjen e të drejtave të komunitetit maqedonas. Vitet e fundit dua të theksoj faktin që ne jemi në një presjon për asimilimin, sidomos nga shteti Bullgarisë. Duke qenë anëtar i BE-së, ka bërë gjithë presionin për asimilimin e komunitetit maqedonas në Shqipëri. Pse e them këtë, ku është lidhja me ankesën? Sekretari i KZAZ-së është personi përgjegjës që merret direkt... pra procesi i asimilimit shkon njëherë nëpërmjet dhënies së pashaportave bullgare. Dua të sqaroj se sekretari është personi përgjegjës që merret me këtë punë dhe pengesa për mosregjistrimin përveç politike lidhet edhe direkt me moslejimin e partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian” të mbrojtë interesat e komunitetit maqedonas atje në atë zonë dhe zotëria në 11:45 ka qenë para objektit të KZAZ-së dhe ka qenë i pari që ka thënë po ne kur ja kemi marrë partisë së Tom Doshit listën si mos të ja marrim listën partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin Europian”, por mbasi sekretari e ka thirrur në ambjentet e KZAZ-së zotëria e ka ndryshuar qasjen dhe i ka hedhur përtokë dokumentet e partisë tonë dhe një nga shkaqet që unë pretendoj që këtë veprim e bëri zotëria sepse zotëria ka aplikuar bashkë me familjen për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

pashaportë bullgare dhe sekretari që merret direkt kush merr, kush nuk merr pashaportë bullgare ka bërë presione që ai mos të firmosë.

Z. E. Çefa: Ti përmbahemi detajeve të çështjes.

Z. J. Nikolla, sekretar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Vasil më trego çfarë vendimmarrje ka sekretari në KZAZ?

Z. E. Çefa: Ja një sekondë ju lutem. Do të mbarojë gjithsecili dhe pastaj të keni të drejtën e fjalës për replikat, sigurisht ligjore, jo ekstra ligjore. Kryetar mbaruat? Keni gjë tjetër për të thënë?

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Po, Anëtarët e KZAZ-së, një pjesë e mirë janë në konflikt interesi me Kodin Zgjedhor. Sipas nenit 32 të Kodit Zgjedhor anëtari, sekretar i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur: Neni 32, pika 1, shkronja a, kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë. Pika b, janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëpartiake të një partie apo koalicioni që konkuron në zonë. Pra, anëtari i Partisë së Lirisë Nasi (*nuk kuprohet qartë*) ka të fejuarën e tij në listën shumëpartiake të koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Anëtari i Partisë Socialiste Niko Kolamovski dhe sekretari i KZAZ-së Jani Nikolla janë të punësuar në Bashkinë Pustec ku kryetar figuron kryetari aktual i bashksë si dhe sekretari Jani Nikolla ka dhe kushërirën e parë në listën shumëpartiake të PS-së. Pra këta zotërinj janë në konflikt interesi dhe nuk mund të marrin vendimmarrje për regjistrimin apo jo të partisë sonë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Kërkojmë edhe shkarkimin e krytarëve të KZAZ-së, si dhe të anëtarëve, faleminderit.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Një pyetje për ata anëtarët që janë bashkë. Shpjegimi juaj për ngjarjen është i njëjtë me shpjegimin që jep kryetari?

Përfaqësues i PL-së: Unë jam anëtar i Partisë së Lirisë, isha përmendur nga kryetari i partisë “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European”.

Z. I. Rusmali: Mos devijoj nga pyetja të lutem. Dua vetëm kaq. Ju shpjegoni të njëjtën ngjarje siç e shpjegon kryetari apo e shpjegoni ndryshe ngjarjen?

Përfaqësues i PL-së: (nuk kuptohet)

Z. I. Rusmali: Për Kryetarin e KZAZ-së, sa subjekte janë regjistruar atje?

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Në KZAZ janë regjistruar 5 subjekte, konkretisht Partia Socialiste, Partia Agrare, PSD-ja, PDS-ja dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe ka dy kandidatë. Kandidati i Partisë Socialiste dhe kandidati i koalicionit “ Bashkë Fitojmë”.

Z. L. Braho: Këto pesë subjekte, secili prej tyre ka sjellë lista shumemërore për këshill?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Po.

Z. L. Braho: Sa është përbërja e listës shumemërore?

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Përbërja e listës shumemërore sipas KZAZ-së sonë është më 16 anëtarë.

Z. L. Braho: Dhe ju thoni që ankimuesi ditën që ka ardhur ose më saktë mesnatën që ka ardhur për të depozituar nuk e kishte listën.

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Po, listën e ka nxjerrë bosh në tavolinë.

Z. L. Braho: Po kartat e identitetit dhe formularët i kishte? Sepse besoj ajo lista shoqërohet dhe me dokumentacion tjetër. Pra përveç listës shumemërore...

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Më kupto tani, pavarësisht se flasim ne përsëri për ushqim, miqësi, ne jemi Brenda rrethit aty, nuk e di se cili është problemi. E fundit fare, me dëshirën e mirë për ta regjistruar subjektin në fjalë pavarësisht se thotë në orën 23:00 sepse ky bridhte arave të Maqedonisë për të gjetur kandidat dhe kartë identiteti, unë kam thirrur anëtarët në 00:40 që të vinë në KZAZ.

Z. I. Rusmali: Deklaratat, kandidatët e listës i kanë patur bashkë me listën apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Asgjë, dy deklarata, nuk kishte kartën e identitetit dhe i thashë unë ti nuk ke as kartë identiteti. Unë e kam në telefon tha.

Z. K. Bele: Subjekti është regjistruar rregullisht në zgjedhje?

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Po.

Z. K. Bele: Dhe aktualisht ka katër këshilltarë, se nuk e kuptova drejt apo jo?

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Po, ne kemi vërtetimin e bashkisë.

Z. K. Bele: Pra ju keni katër këshilltarë dhe keni marrë pjesë rregullisht në zgjedhje.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Po.

Z. K. Bele: Po në zgjedhjet e mëparshme keni patur ndonjëherë probleme me këto oraret apo e keni bërë gjithmonë brenda...pra a keni qenë ndonjëherë në një situatë të ngjashme, sepse besoj ndonjë nga ju do të ketë ndonjë eksperiencë. Ju anëtarët e KZAZ-së, keni eksperiencë të mëparshme në KZAZ?

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Po, eksperiencë kam, janë paraqitur brenda orarit kur janë regjistruar. Kur unë mbaj mend...

Z. K. Bele: Pra, është hera e parë në KZAZ?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Tani se çfarë problem ka patur nuk e di.

Z. K. Bele: Nuk ka rëndësi, doja të kuptoj sepse në KQZ në dijeninë time ka patur raste të mjaftueshme ku vihet 15 minuta, gjysëm ore, një orë e gjysëm apo në të gëdhirë me vonesë. Thjesht për ta ditur.

Z. L. Braho: Të njëjtën pyetje e kam për ankimuesin, për kryetarin e partisë ankimuese. E keni patur të gjithë dokumentacionin të plotësuar, qoftë në orën 23:55, qoftë 00:05, 00:20. Pra listën shumëmeërore, formularët përkatës, deklaratat nga kandidatët, kartat e identitetit, e keni patur gjithë dokumentacionin gati për ta depozituar?

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Po e kemi patur gjithë dokumentacionin dhe ne kemi qendruar gjysëm ore brenda në KZAZ, nuk kemi qenë vetëm pesë minuta dhe i kanë parë një për një të gjithë dokumentet dhe procesi ka vazhduar normalisht. Presioni i kandidatit të opozitës ka qenë i vazhdueshëm dhe sekretari më pas më mori në tëefon dhe më tha të kam mik, mos i merr dokumentat, do të kesh probleme, do të denoncoj, ka bërë presjon për anëtarët e tjerë. Dhe pas gjysëm ore në përfundim të procesit të kontrollit të të gjithë kandidatëve sekretari ka nxjerrë jashtë anëtarin e KZAZ-së dhe kur ka ardhur zotëria e ka ndryshur qasjen komplet. Ka marrë e i ka hedhur dokumentat në tokë dhe ka filluar një sjellje arrogante që unë të reagoj që të ndërpresë procesin. Ky ka qenë qëllimi dhe unë prandaj dyshoj që kanë qenë këto lidhje, Presjoni nga...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. L. Braho: Dakord! Kam një...se di sa mund të ma sqarojë Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së në këtë histori që besoj është më i pandikuari. Çfarë dokumentacioni kemi këtu për këtë rast. Procesverbalin e marrjes së dokumentave në dorëzim. Vendimin e KZAZ-së dhe vendimi i KZAZ-së, në fillim patëm një vendim me tre anëtarë, nuk kemi asnjë nga...

Z. Y. Merkaç: Nuk kemi vendimmarrje të KQZ-së jo.

Z. L. Braho: Pra nuk ka vendimmarrje, as refuzim, as kthim për plotësim dokumentash.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Kam bërë një procesverbal në 00:15 e kanë shënuar dhe unë kam insistuar që ta shënojnë 23:55. Atë procesverbal nuk e di, e kanë këtu apo nuk e kanë, 00:15 kanë shënuar orarin sepse zotëria thotë 00:40 kam qenë atje domethënë para godinës. E kemi shënuar 00:15. E keni procesverbalin? Nxirreni sepse nëse e keni ndryshuar është fallsifikim direkt dhe do të mbani përgjegjësi për këtë punë.

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje, qoftë për administratën, qoftë dhe për përfaqësuesit e KZAZ-së. Në ankim deklarohet që është komunikuar me KQZ-në për këtë problem dhe nga KQZ-ja është rekomanduar regjistrimi i subjektit. Kush është personi, pra nëse është e vërtetë duhet të ma konfirmoni nëse kjo është e vërtetë dhe e dyta kush është personi në KQZ me të cilin keni kontaktuar dhe ju ka orjentuar që të regjistrohet.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. J. Nikolla, sekretar i KZAZ-së nr. 71: Në rradhë të parë dua ti them Vasilit, nuk e di përse i politizon gjërat kur unë kam fakte. Dymbëdhjetë telefonata i kam bërë përpara kësaj. Nëqoftëse kisha dëshirën për mos të regjistruar dhe për të ndikuar në regjistrimin...Këto janë të gjitha gënjeshtra dhe mbaj përgjegjësi të plotë. Për sa i përket telefonatave të KQZ-së. Kemi bërë përpjekje dy herë për tu lidhur me KQZ-në, nuk na është hapur telefoni

Z. E. Çefa: . Atë natë. Pas mesnate bëhet fjalë. Po të nesërmen?

Z. J. Nikolla, sekretar i KZAZ-së Nr. 71: Të nesërmen kemi komunikuar. Na kanë pyetur a ka dorëzuar ndonjë dokument, ti jepni kohë që ta plotsojë dokumentacionin? Unë i thashë që nuk ka dorëzuar asnjë, pasi listat shumë më të shumta i kishte bosh dhe anëtarët nuk kanë rënë dakord për të pranuar dokumentat. Thjesht kemi ndjekur udhëzimet e KQZ-së për të pranuar edhe në 00:00 të natës 27.03.2023 dokumentat, kaq.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Më falni por unë në 28.03.2023 vet kam komunikuar, mbasi kemi folur me zotërinjtë, me zonjën Pavlina, nuk e di mbiemrin. Ajo më ka thënë që... Kam komunikuar kur kam regjistruar partinë ndaj e kisha numrin. I thashë zonjë kemi një problem në Bashkinë Pustec, nuk mi marrin dokumentat. Ajo më tha ti ishe ai që ishe pa dokumenta, partia jote, pra zotëria ka komunikuar me zonjën Pavlina. Tani po të zbardhim tabulatet e telefonatave të dalin të gjithë gënjeshttrat që thuhet këtu. Edhe atë pjesë do e mendojmë, faleminderit.

Z. E. Çefa: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. K. Bele: Një pyetje kam për KZAZ-në. Nëse ai set dokumentash në atë gjendje që ju thoni, po i hyjmë debatit lidhur me cilësinë e dokumentave që ju pretendoni që kishte mungesa thelbësore, zotëria thotë që kanë qënë të plota. Keni diferenca të caktuara. Nëse një set dokumentesh me aq karta identiteti, me dy deklarata dhe me atë shkrimin e dorës që do e mbushte, do të ishte pranuar, i lind e drejta që ti jepni 48 (dyzet e tetë) orë kohë për ta plotësuar? Ju për sa kohë e futët në proces dhe i pranuat dokumentet në orën 00:05, do të thotë që ju keni pranuar të administroni dokumentet. Shkaku i kohës bie. Nëse unë të pres në 04:05 kur mbyllet dera dhe të them po hajde dhe pastaj nuk mund të të nxjerr jashtë duke të thënë kishte kaluar ora. Në momentin që ju e keni futur në proces dhe e pranoni, keni pranuar të shqyrtoni dokumentacionin në atë gjendje që ishte, është rasti që ka filluar procedura administrative e shqyrtimit. Pastaj vimë tek faza tjetër, ka apo nuk ka dokumente. Pyetja që unë kam për ju dhe ju ftoj që të shkëputeni një moment nga debatet dhe nga ato akuzat që palët i bëjnë njëra-tjetrës dhe ta mendoni me qetësi. Të njëjtën pyetje kam edhe për Sekretarin e Përgjithshëm. Nëse pala në momentin që fillon shqyrtimin me një set të caktuar dokumentesh, për një subjekt që është aktualisht pa mandate, që ka marrë pjesë në çdo garë, pra nuk është një njeri i panjohur që i bie derës. A do të duhej të administrohej në atë gjendje që ishte dhe ti kthehej për plotësim apo ti kërkohet plotësimi sipas rregullimit që ka ligji? Pra e lëmë orarin, sepse orarin e kemi kapërcyer vet duke i marrë letrat në dorëzim.

Z. Y. Merkaj: Po, ne kemi patur raste kur KQZ-ja vepron si KZAZ për disa bashki që territori i tyre mbulohet nga më shumë se dy KZAZ, merr dokumentet dhe listat shumë më të partive politike. Kemi patur raste kur me vendimmarrje të Komisionerit është kthyer lista për plotësim pasi kanë qënë e pasaktë. Për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

momentin çfarëdo lloj dokumenti të sjellë një parti politike merren në shqyrtim nga KZAZ-ja, mbahet procesverbali në librin e protokollit të procesverbalit dhe thuhet që kjo parti ka sjellë këtë dhe i lihet kaq kohë për të plotësuar listat, 48 (dyzet e tetë) orë dhe brenda afatit 48 (dyzet e tetë) orësh duhet ti plotësojë, në të kundërt pastaj del me vendim për mosregjistrim.

Z. K. Bele: Si keni proceduar kur ky administrim ka ndodhur pak minuta apo pak orë pas afatit.

Z. Y. Merhaj: Gjithmonë kemi favorizuar partitë, e kemi toleruar afatin.

Z. K. Bele: Faleminderit!


Z. L. Braho: Kam unë një pyetje tjetër. Tani ky seti i dokumentacionit besoj që është depozituar nga ankuesi dje. Këtu ka dy procesverbale dorëzimi. Një procesverbal dorëzimi që ka një nënshkrim nga marrësi në dorëzim që nuk e kuptoj se e kujt është firma.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: (pa mikrofon, nuk dëgjohet)

Z. L. Braho: E KQZ-së këtu? Kjo ka përmbajtje, procesverbali 27.03.2023, që është kjo tjetra që ka firmën e...

Nga salla (pa mikrofon, nuk dëgjohet)

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. L. Braho: Pra është e gjitha plotësim i juaji. Po kjo vërejtja këtu? Kush e ka shkruar? Kjo është bërë nën protokoll të KQZ-së. Pra nga KZAZ-ja ju nuk keni asnjë dokument.

Nga salla (pa mikrofon, nuk dëgjohet)

Z. L. Braho: Po ju e keni mbajtur në libër protokollin këtë ngjarjen që treguat? E keni shënuar në libër protokollin të KZAZ-së, që është paraqitur zotëria në orën që ju pretendoni në bazë të dokumentacionit?

Z. J. Nikolla, sekretar i KZAZ-së nr. 71, Pustec: Po.

Z. L. Braho: Mund të na jepni një kopje?

Z. E. Çefa: Atëherë dakord! Do e administrojmë si provë. Ndërkohë do të kalojmë tek konkluzionet e fundit. Ankuesi pra shkurtimisht çfarë kërkoni?

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Kërkojmë të pranohet ankesa dhe të regjistrohemi, plus të merren seriozisht çfarë janë konflikt interesi, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Kjo nuk është çështje...

Z. E. Çefa: Kjo nuk është çështje e ankimuar.

Z. V. Sterjovski, kryetar i AMIE-së: Dakord si ta mendoni atë pjesë, por kryesore është që në vija të drejta të garojmë në zgjedhje, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

Z. E. Çefa: Mirë atëherë, përfaqësuesit e KZAZ-së përfundimisht çfarë kërkoni nga KAS? Çfarë qëndrimi keni përfundimisht domethënë.

Z. N. Nokollovski, nënkryetar i KZAZ-së 71, Pustec: Ne e thamë që dëshira jonë e madhe ishte që ta regjistronim, por kur një kryetar partie dhe ish-deputet të vjen në tavolinë me listat bosh, me listat shumë më të shumta, si ta regjistronim ne.

Z. E. Çefa: Dakord faleminderit! Atëherë ne do e ndërpresim këtu seancën. Do të këshillohem me njëri tjetrin dhe besoj për pak ndoshta, 10 minuta, 15 minuta do të ju thërrasim sërish që të shpallim vendimin. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 12:04

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit. Atëherë KAS pasi diskutoi çështjen në tërësi vendosi:

1. Pranimin e ankimit të subjektit “Alenca e Maqedonasve per Integrimin European”. Detyrimin e KZAZ-së nr. 71, të Bashkisë Pustec të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesën për regjistrim të subjektit ankues.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Brenda 5 (pesë) ditëve.

Vendimi nr. 42

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

03.04.2023
Ora 12:10

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 44.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Do të zhvillojmë procedurën e shortit për caktimin e relatorit, kërkesë ankimore numër 44, sot në datën 03 prill 2023 ora 12:10, referuar nenit 14 rregullores së KAS-it kemi përgatitur 5 shirita letre ku në njërin është shënuar kërkesa ankimore numër 44, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Shiritat vendosen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Një përfaqësues i KQZ-së pasi i palos shiritat e letrës i fut në një enë transparente, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së t’i tërheqi goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar me rendin alfabetik të emrit rritës.

Nga zoti Ervin Lako, Elvis Cefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe zoti Ledio Braho.
Perzihen goglat:

-Tërhiqet gogla e parë -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - kërkesa ankimore numër 44.

- Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. E. Çefa: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. I. Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. K. Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. L. Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit relator i kërkesës ankimore numër 44 është caktuar relator zoti Ervin Lako, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

3.04.2023
Ora 12.34

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 39, datë 29.3.2023 të “Nismës Thurje” me objekt “Ankim administrativ ndaj vendimit nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 82, Bashkia Dropull” për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie të partisë “Nisma Thurje”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** “Nisma Thurje” KZAZ nr. 82

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 39, të paraqitur nga zoti Kosta Garo, në cilësinë e kandidatit dhe nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, kundër vendimit nr. 10, datë 23 mars 2023 të KZAZ-së nr. 82, Bashkia Dropull, rrethi Gjirokastrë. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është në prezencë të plotë trupa e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i ankuesit, zoti Garo, po ashtu edhe përfaqësuesi i “Nismës Thurje” i subjektit zgjedhor, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata. Janë prezentë gjithashtu edhe anëtarët e KZAZ-së nr. 82, të cilët për efekt procesverbali do të na prezantohen shkurtimisht me emër.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. V. Qanta: Vasil Qanta, anëtar.

Znj. K. Zhako: Kristina Zhako anëtare.

Z. G. Dushi: Gligor Dushi, kryetar.

Z. V. Biralia: Vangjel Biralia, anëtar.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë sipas procedurës, po ia jap fjalën menjëherë ankuesit ose ankuesve që të parashtrajnë shkurtimisht kërkesën e tyre ankimore përpara KAS-it.

Z. E. Shabani: Përshëndetje! Endrit Shabani, drejtues i “Nismës Thurje”. Hierarkia ligjore në këtë vend nis me Kushtetutën, e cila tek të drejtat politike, neni 45, garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çfarë kemi konstatuar, arsyeja pse kemi ardhur këtu, është sepse një parti politike, që kontrollon KZAZ-në nr. 82 ka vendosur në mënyrë të kundërligjshme të pengojë pjesëmarrjen në garë të subjektit zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidatit të saj Kosta Garos. Cilat janë rrethanat e çështjes? Në datën 27 mars 2023 kryetari i KZAZ-së nr. 82, zoti Gligor Dushi, që sot është prezent, ka firmosur me dorën e tij procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, të cilin ju e keni në dispozicion, ku nuk ka asnjë pretendim për mungesë dokumentacioni. Së dyti, në vend që të bënin detyrat e ngarkuara nga ligji, anëtarët e PS-së në këtë KZAZ, në kushtet e shpërdorimit të detyrës, kanë ekspozuar listën e nënshkruesve tek zyrtarët vendorë në Dropull, ç’ka në fakt, siç mund t’ju tregojë edhe më tepër kandidati Kosta Garo, ka sjellë presion

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

mbi zgjedhësit, që vazhdon edhe sot. Ndërkohë që nenin 71, pika 3, të Kodit Zgjedhor e kufizon detyrimin e KZAZ-së për të verifikuar vetëm 5% të listët që në këto kushte janë 10 vetë. Kandidati Kosta Garo ka kontaktuar me të paktën 20 vetë, të cilët pretendojnë që janë telefonuar dhe janë kërcënuar pse kanë firmosur në këtë listë. Së treti, në datën 28 mars, pra një ditë pas depozitimit të kërkesës, ora 21.23, me vendimin nr.10, KZAZ-ja nr. 82 ka marrë një vendim, ku ka përjashtuar kandidatin Kosta Garo nga gara, ndërkohë që Kosta Garo nuk ka qenë prezent në këtë mbledhje dhe kjo mbledhje nuk është bërë publike. Neni 71, pika 3 e Kodit Zgjedhor e detyron KZAZ-në në mënyrë eksplicite që të zhvillojë një seancë publike në prani të palëve të interesuara dhe këtu citoj Kodin Zgjedhor: “Ku të paraqitet një raport i detajuar mbi mangësitë e konstatuara”. Jo vetëm që kjo mbledhje nuk është bërë publike, jo vetëm që këto kushte nuk janë plotësuar, por ky vendim, që ju e keni në dispozicion, edhe sot e kësaj dite nuk ka të justifikuar çfarë mungon në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati. I gjithë ky proces i verifikimit të nënshkrimeve nuk ka qenë transparent, ndërkohë që pika 4 e nenit 71 të Kodit Zgjedhor kërkon, dhe këtu citoj: “Procedura e verifikimit të zhvillohet në mënyrë publike”. Kështu që nxjerrja e këtij akti, siç është akti nr. 10, në kundërshtim me dispozitat e Kodit, me kërkesat e Kodit Zgjedhor u ka mohuar palëve, në këtë rast “Nismës Thurje” dhe kandidatit Kosta Garo mundësinë për të verifikuar ligjshmërinë e këtij procesi dhe të këtij akti, por edhe për të ofruar edhe argumentet e tyre kundër apo për të përmbushur detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, një e drejtë që ia jep Kodi Zgjedhor, ku sipas nenit 73 i jep mundësinë që të plotësojë dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar. Në këto kushte, në arsyetim të Kodit Zgjedhor, por edhe nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, ju kërkoj ta shpallni vendimin nr.10 të KZAZ-së të pavlefshëm dhe të regjistroni kandidatin Kosta Garo. Dua të them edhe diçka të fundit. Legjislacioni

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

shqiptar ia njeh të drejtën e hetimit prokurorisë, qoftë Kushtetuta, qoftë Kodi i Procedurës Penale. Nuk ia njeh të drejtën e hetimit KZAZ-së. Megjithatë, Kodi i njeh mundësinë KZAZ-së që të verifikojë të dhënat e zgjedhësve, të cilët kanë nënshkruar në mbështetje të kandidatit. Neni 71, për kujtesë, i Kodit Zgjedhor në mënyrë eksplicite e kufizon objektin e verifikimit të KZAZ-së dhe këtu citoj: “Nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit të nënshkrimit”. Në këto kushte, nëse KZAZ-ja nr. 82 ka konstatuar nënshkrime të parregullta, neni 71, pika 3 e Kodit e detyron që të zbresë këto nënshkrime nga numri total i nënshkrimeve dhe të pranojë listë, këtu citoj përsëri Kodin: “Nëse ajo është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet sipas këtij Kodi.”. Për rikujtesë, Bashkia Dropull ka 20 mijë zgjedhës në listë dhe sipas nenit 68, pika 2, duhet 1% e firmave të zgjedhësve në listë, janë 200 nënshkrime. Unë i kam me vete, ju e keni një kopje të nënshkrimeve, në mënyrë publike ju kërkoj juve, meqenëse KZAZ-ja nuk e ka bërë, gjeni 1% të këtyre këtu që nuk janë banorë të Dropullit, pra në Bashkinë Dropull, dhe nëse gjeni mbi 16 njerëz, vetëm atëherë Kodi Zgjedhor i jep mundësinë KZAZ-së që ta përjashtojë kandidatin nga gara. Në kushte të tjera, kandidati duhet të lejohet të marrë pjesë në zgjedhje dhe të ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese për t’u zgjedhur. Për ta mbyllur, do të them diçka. Ju lutem, shikojeni tablonë e qartë, sepse këtu kemi të bëjmë me një vendim politik, jo vendim ligjor; kemi të bëjmë me një parti, e cila kontrollon KZAZ-në nr. 82, e cila katër vjetët e fundit ka kontrolluar 100% të të gjitha bashkive dhe vazhdon t’i trembet garës duke mos lejuar të marrë pjesë në zgjedhje. Për sa u përket institucioneve, këto institucione kanë lejuar këtu, i kanë garantuar të drejtën kushtetuese Valdin Pjetrit, i dënuar për trafik droge në Itali; i kanë lejuar të drejtën për të garuar në zgjedhje Agim Kajmakut, i dënuar për trafik droge në Greqi; i kanë lejuar të drejtën për të kandiduar Elvis Roshit të dënuar për përdhunim në Itali; së

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

fundi i kanë lejuar kandidimin Kreshnik Hajdarit si i dënuar në Greqi. Po, po. Sot i pengojnë Kosta Garos të drejtën kushtetuese për t'u regjistruar në zgjedhje duke shtruar pyetje: çfarë krimi ka bërë ky njeri? Pra, e drejta për të garuar është një e drejtë kushtetuese, e cila mund të kufizohet vetëm me vendim të formës së prerë të gjykatës. Jua them unë dhe po e mbyll fjalën: Kosta Garo ka bërë një krim. Në vitin 2021, në zgjedhjet e fundit, ka marrë dy herë më shumë vota se ministri i Brendshëm në Dropull dhe 7 herë më shumë vota se drejtuesja e qarkut, që është ministre e Turizmit. Ky është krimi i Kosta Garos, kjo është arsyeja pse Partia Socialiste që kontrollon KZAZ-në nr. 82 e pengon për pjesëmarrje në garë. Ju ftoj të mos bëheni pjesë e kësaj pengese.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Kandidati ka diçka për të shtuar? Për momentin jo. Atëherë nga përfaqësuesit e KZAZ-së kush e do fjalën? Urdhëroni, kryetar!

Z. G. Dushi: Jam kryetari i KZAZ-së Dropull. KZAZ-ja Dropull që në momentin kur është krijuar, ka punuar konform Kodit Zgjedhor për të zbatuar të gjitha sipas afateve dhe sipas rregulloreve që përshkruan ky Kod. Jo për faj të KZAZ-së Dropull e të Partisë Socialiste, siç përmendet, por për faj të KQZ-së dhe të subjekteve opozitare, kurrë nuk është plotësuar numri i anëtarëve të komisionit zgjedhor. Edhe sot e kësaj dite ne nuk kemi anëtarë të opozitës në komisionin zgjedhor, të cilët e bëjnë qëllimisht. I kemi pritur ditën e shtunë për t'u paraqitur dhe nuk kanë ardhur. Edhe sot nuk kemi sekretar dhe i gjithë ky problem nuk vjen sepse ne e kemi inat Kosta Garon, Kosta Garoja ka qenë miku dhe shoku ynë, apo sepse kemi inat me subjektin që përfaqëson Kosta Garoja. KZAZ-ja, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka marrë të gjithë dokumentacionin konform ligjit të të gjitha subjekteve në datën 27 dhe në bazë të të gjitha parashikimeve deri në orën 24.00, në prani kjo edhe

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

të monitoruesit të KQZ-së, zotit Arian Gjini, sepse, duke qenë se ishin këto problematika, i kam kërkuar drejtorit të KQZ-së për ndihmë juridike një person të KQZ-së për këto rrethana ku ndodhej Bashkia Dropull. Megjithatë, subjekti politik na nxori sot një procesverbal ku thuhet: dorëzohet lista e kandidatëve. Po, u dorëzua lista e kandidatëve. Unë e kam firmosur që kam marrë listën e kandidatëve, pa kartën e identitetit. Është e shkruar në procesverbal. Është shkruar te protokolli i mbledhjes. Protokolli i mbledhjes e ka të qartë që Kosto Garoja, dhe iu la afat, që deri në datën 28, ora 16.00 të plotësojë kartat e identitetit. Në këtë mënyrë kemi vazhduar punën edhe ditën e nesërme, në datën 28. Kemi filluar së pari me të gjitha subjektet që kanë dorëzuar dokumentacionin dhe janë marrë me radhë. Në orën 16 që përfundonte afati i “Nismës Thurje” janë marrë në telefon disa herë, jo do të vijmë për gjysmë ore, sepse janë njerëz që ngarkohen për fotokopje të kartave të identitetit. Nuk na janë paraqitur deri në orën 9. Ndërkohë gjatë ditës, po në prani të monitoruesit të KQZ-së, ne kemi bërë sipas ligjit zgjedhor, monitorimin e listave zgjedhore, ku kemi gjetur parregullsi me kartat e identitetit dhe në telefona. Kemi gjetur parregullsi, më vjen zor që unë si përfaqësues i minoritetit ndodhem në këtë vend bashkë me mikun tonë Kosta Garon, por në listën zgjedhore të jetë një emër dy herë, unë nuk ia fal; që në listën zgjedhore të ketë njerëz që nuk banojnë në atë zonë, kjo është e padrejtë në bazë të ligjit zgjedhor dhe kështu kemi bërë disa telefonata për të cilat kemi thënë edhe herën e kaluar si dokumentacion, ku janë marrë persona të veçantë në telefon, por telefoni ose ishte i mbyllur e nuk dispohej, ose i përkiste një njeriu tjetër. Kjo tregon që të dhënat janë të gabuara. Në bazë të kësaj ne kemi bërë 17 telefonata, të gjitha me të dhëna të gabuara dhe njerëz që e kanë vënë emrin dy herë ose njerëz që të njëjtin numër telefoni e kanë paraqitur disa herë në këto lista. Për shkak të këtyre parregullsive dhe të vonesave në dokumentacion, ne u detyruam të merrnim vendimin nr.10, që ia kemi dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. E. Çefa: Pala ankuese ngriti një problem për sa i përket verifikimit. Pra, pretendimi i tij ishte që ligji ju limiton vetëm në një lloj verifikimi, jo në kontaktin e secilit, por në verifikimin nëse personat në listë janë apo jo banorë të zonës zgjedhore. Të lutem, këtu na shpjego qëndrimin që keni mbajtur.

Z. G. Dushi: Nuk janë banorë të zonës, të cilët nëpërmjet telefonit ishin banues në Gjirokastër dhe janë në procesverbalin që ju kemi dërguar seancën e parë. Janë edhe persona të tjerë që janë banues në Sarandë.

Z. L. Braho: Banues ju nënkuptoni banues *de fakto* apo janë...

Z. G. Dushi: Me gjendje civile.

Z. L. Braho: Janë te lista e zgjedhësve të bashkive të tjera, jo Bashkisë Dropull.

Z. G. Dushi: Po. Gjithashtu...

Z. L. Braho: Si e provoni këtë? Keni shkresa? Si provohet ndjekja e procedurës...

Z. G. Dushi: Nëpërmjet emrave që ju kemi dërguar juve dhe nëpërmjet listës.

Z. L. Braho: Nga procesverbali që ju vetë keni sjellë, rezulton se keni kontaktuar 6 persona.

Z. G. Dushi: 17 persona.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. L. Braho: Në procesverbal keni shënuar 6, te libri i protokollit.

Z. G. Dushi: 17 se nuk keni fotokopjuar faqen tjetër, nuk e di. Nga disa denoncime që kanë bërë banorët për shkak se kartat e tyre të identitetit janë përdorur për...

Z. L. Braho: Në çfarë date ka ndodhur ky verifikimi i 17 personave?

Z. G. Dushi: Në datën 28.

Z. L. Braho: Në datën 28, ora 20:00 kam këtë unë me 6 persona.

Z. G. Dushi: Vazhdo edhe te faqja tjetër. Janë 17 persona, që duke hequr disa njerëz nga 215 veta, bie numri nga 200.

Z. I. Rusmali: 200 është minimumi që kërkohet.

Z. G. Dushi: Po. Plus kësaj disa banorë, kartat e identitetit u janë përdorur në mënyrë të pavetëdijshme, kanë bërë denoncim te prokuroria e Gjirokastrës...

Z. L. Braho: Edhe një herë për pjesën e identifikimit që këta 17 persona janë apo nuk janë në listën e zgjedhësve të Bashkisë Dropull. Si provohet kjo?

Z. G. Dushi: Nëpërmjet telefonave që ne morëm.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. L. Braho: Ju e bëni këtë nëpërmjet pohimit apo mohimit që kanë bërë ata në telefon, ndërkohë me shkresë të Bashkisë Dropull nuk u keni dërguar një kërkesë...

Z. G. Dushi: Nuk u jemi drejtuar me shkresë Bashkisë Dropull, se unë nuk kam sekretar.

Z. E. Shabani: Kam një kërkesë. Kodi Zgjedhor kërkon që verifikimi të bëhet publik. Ne jemi këtu, unë kam listën e firmosësve. Unë kërkoj emrat e 17 njerëzve, 17 firmosësve këtu, të cilët aktualisht nuk janë zgjedhës në Bashkinë Dropull. Nëse më gjen 16, jo 17, 16 emra që ne mund t'i verifikojmë, çdo qytetar mund të futet te faqja e KQZ-së tani, të verifikojë 16 emra nga kjo listë që nuk janë zgjedhës në Dropull, unë i kërkoj ndjesë KQZ-së që i kam marrë kohën, i kërkoj ndjesë KZAZ-së që kam ardhur këtu, në të kundërt jemi në shpërdorim të detyrës. Ja ku kemi, sfidë publike, ja ku janë listat, 16 emrat dhe mbiemrat e atyre që kanë nënshkruar këtu, që aktualisht nuk janë zgjedhës në Dropull.

Z. G. Dushi: Zoti Shabani, ne kemi bërë çdo gjë me udhëzim...

Z. E. Shabani: Më jep 16 emrat.

Z. L. Braho: Ylli, mund ta verifikojmë këtë? Besoj nuk ka ndonjë vështirësi për pjesën a janë zgjedhës të Bashkisë Dropull apo jo.

Z. Y. Merkaj: Shumë kollaj.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. G. Dushi: Po, nëse këta persona që kanë vënë emrat këtu dhe janë firmosur nga personat e tjerë, të cilët nuk ishin të pranishëm?

Z. E. Shabani: Ai që ka falsifikuar të shkojë në burg, por këtu nuk jemi në prokurori. Këtu jemi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: A janë zgjedhës të Bashkisë së Dropullit, apo nuk janë?

Z. G. Dushi: Një pjesë e tyre janë, që nuk janë zgjedhës së Bashkisë së Dropullit dhe së dyti janë që kanë dhënë informacion të gabuar, që kanë dhënë emrat e Bashkisë Dropullit, ndërsa emri i përkiste njerëzve që janë në Gjirokastrë.

Z. E. Shabani: Mua më vjen keq që zotëria nuk e ka lexuar Kodin Zgjedhor. Kodi Zgjedhor objekt verifikimi vendos vetëm nëse nënshkruesit janë zgjedhës në bashkinë përkatëse. Zotëria ka ngritur një pretendim, 17 prej këtyre nuk janë zgjedhës. Ky është një pretendim lehtësisht i verifikueshëm tani live publikisht siç e kërkon Kodi Zgjedhor. Çdo qytetarë shqiptarë ka mundësinë të futet online në KQZ dhe të shohë listën e zgjedhësve. Ju e keni si KQZ, bashkia e ka. Të më thotë 16 emra publikisht, unë do t'i shënoj do t'i verifikoj, nëse ata nuk janë realisht zgjedhës unë i kërkoj ndjesë, ne tërheqim ankimin. Në të kundërt, jemi në kushtet shpërdorimit të detyrës, dhe në mohimin e një të drejte themelore kushtetuese, e cila jo më kot është e drejta e parë në kreun për të drejtat politike, e drejta për t'u zgjedhur, për të marrë pjesë në zgjedhje.

Z. E. Çefa: Po, zoti Bele.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. K. Bele: Unë bie dakord me mendimin që e drejta për t'u zgjedhur është e drejtë kushtetuese, po aq i rëndësishëm është edhe legjislacioni në zbatim të kësaj të drejte që garanton të jetë një proces i rregullt, dhe prandaj jemi në këtë seancë. Unë shoh këtu listën me 215 nënshkrime. Tani, për ta kuptuar edhe ne më mirë, në vështrim të parë shoh se këto janë plotësuar nga e njëjta dorë, që do të thotë, siç e kuptoj unë, që procedura është zhvilluar në këtë mënyrë që kur është paraqitur qytetari iks, numri 1, për shembull, nuk po i lexoj emrat, personi, që ka pasur listën, ka shënuar emrin, adresën, dhe ai, mbështetësi, ka hedhur vetëm formën. Pra, personi nuk e ka shënuar vetë emrin, por ka hedhur vetëm firmën.

Z. K. Garo: Përpilimi i listës së firmuesve është bërë nga 4-5 persona, nuk është vetëm një shkrim, po që se do ta shikoni me vëmendje, që janë grupi i punës, mbështetësit e mi dhe njerëz të afërt.

Z. K. Bele: Do t'i marrim me radhë, pra këta njerëz këta njerëz kanë shkruar emrin, datëlindjen dhe adresën.

Z. K. Garo: Duke qenë se përpilimi kërkon të jetë me shkronja kapitale dhe të mos ketë gabime, kështu e kërkon formulari, janë caktuar njerëz nga ana ime, që të plotësojnë gjeneralitetet. Personi, që është dakord, të bëjë firmosjen, të japë kartën e identitetit që të fotokopjohet, dhe të firmosë mbi kartë. Kjo ka qenë procedura. Madje edhe diçka tjetër që na e vështirësonte marrjen e çdo personi që t'i vendoste vetë, është se një pjesë e votuesve të Bashkisë së Dropullit janë në moshë shumë të madhe, një pjesë e tyre mezi shkruajnë greqisht, jo më shqip, kjo është ideja. Prandaj, ne jemi kujdesur që përpilimi i listave të ishte korrekt nga ana shkrimit dhe e drejtshkrimit.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. K. Bele: Shoh që ka me datëlindjen e 1938, kështu që është e qartë dhe e kuptueshme. Pra, personi ka vendosur firmën. Po numrin e telefonit, e ka shkruar personi apo?

Z. K. Garo: E ka deklaruar vetë personi, numrin kaq dhe aq. Atë ne nuk kemi mundësi t'ia verifikojmë nëse e ka atë numër.

Z. K. Bele: Nuk jemi te verifikimi, jemi te shkrimi. Pra, shkrimi i numrit të telefonit e ka bërë personi që ka e përpiluar.

Z. K. Garo: Po, zakonisht është bërë kjo procedurë, përveç personave që kanë dashur vetë ta përpilojnë.

Z. K. Bele: Në vazhdim i njëjti person ka hedhur firmën e tij këtu dhe te karta. Pra, ju keni bindjen që këto firma këtu dhe këto firma këtu janë të njëjta?

Z. K. Garo: Po.

Z. K. Bele: A i keni bërë ndonjë këqyrje me sy të lirë?

Z. K. Garo: Jo, nuk kam bërë një gjë të tillë, unë personalisht, jo.

Z. K. Bele: Sepse unë, për bindjen time të brendshme, administrata i ka renditur të gjitha dhe po i shikojmë, natyrisht me sy të lirë, se nuk jemi ekspertë kriminalistë,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

kam një të shkuar që lidhet me procesin penal dhe kjo ndoshta më shtyn. Po shikoja firmat.

Z. K. Garo: Nuk kam bërë asnjë lloj verifikimi të tillë duke qenë se edhe personat, që janë marrë...

Z. E. Shabani: A mund t'ju bëj një vërejtje? Edhe unë jam jurist dhe e kam shumë pasion kriminalistikën, por objekti i veprimtarisë së KQZ-së nuk është të zëvendësojë prokurorinë. Unë ju bëj një thirrje dhe unë shpresoj që çdo njeri që shkel ligjin, falsifikon firmat të shkojë në burg, por këtu jemi para një procesi tjetër. Ky nuk është një proces penal, ka një kallëzim paralel, unë shpresoj që ai të shkojë deri në fund. Nëse ka njerëz që kanë shkelur ligjin dhe ka vendim të formës së prerë, pa dyshim, kjo përbën një vendim që është bazuar mbi një akt të vesuar mund ta shpallni të pavlefshëm e të tjera. Në këtë fazë që jemi ka dy pretendime, KZAZ-ja nxori dy pretendime: pretendimi i parë është mosplotësimi i dokumentacionit brenda afatit. Neni 73, pika 2, i Kodi Zgjedhor thotë: 42 ditë.

Z. K. Bele: Nuk kemi nevojë të bësh përmbledhjen e situatës, ne bëjmë pyetje, ju përgjigjeni, sepse ju jeni palë në proces. E vlerësojmë faktin që jeni të thelluar te çështja, por na lini të bëjmë pyetjet dhe na jepni përgjigjet. Unë vetëm këtë desha të kuptoja, dhe për sqarim ne, kur kemi parë në një parti të caktuar një sërë dokumentesh, në përpjekjen tonë dhe në mundësinë tonë më të mirë, rast pas rasti kemi të gjithë të drejtën madje edhe detyrimin që t'i vlerësojmë me njohuritë tona më të mira, dikush mund të thellohet se ka një të shkuar si matematikan, dhe mund të shikojë numrat kur nuk i përputhen, dikush sheh ligjin, ligjin e shohin të gjithë, por dikush sheh elemente të tjera, këtu nuk ka ndonjë gjë. Unë për bindjen time kam

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

parë një pjesë të këtyre gjërave. Megjithatë kjo është një pjesë tjetër është procesi penal ka rrugën e vet.

Përfaqësues i KZAZ-së: Zoti Koli, ne kemi edhe 4 deklarata nga qytetarët.

Z. K. Bele: Kur t'ju pyesim me radhë.

Përfaqësues i KZAZ-së: Dakord.

Z. E. Çefa: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Për të sqaruar pak para se të kthehemi të thelbi i pyetjeve, ne si institucion nuk jemi prokurori, dhe vlerësimi, që ne i bëjmë dokumenteve, nuk është vlerësim prokurorie dhe as prej eksperti, por ne jemi para një situatë faktike që duhet të na çojë ne të bindja: fakti është i vërtetë apo është i rremë. Kjo ka lidhje me mosdorëzimin në afatin e caktuar të fotokopjeve të kartave të identitetit. U shpjegua nga ana e komisionit këtu që ju është dhënë 24 orë afat për kartat e identitetit, ju është kërkuar në mënyrë të përsëritur që ta respektonin afatin, i keni thënë ose nuk dilnit ose i thoshit po vijnë. Dhe këta kanë pritur, në mos gaboj, deri në orën 9 dhe në orën 9 kanë marrë vendimin për refuzimin e regjistrimit për mosplotësim dokumentacioni. Tani ne ndodhemi në situatën që ne i kemi kartat e identitetit dhe ndoshta ne duhet të shohim, do të thotë, a ka pasur vështirësi për plotësimin e kartave të identitetit, që justifikojnë vonesën apo nuk ka pasur vështirësi? A janë plotësuar në rregull apo ka dyshime që janë plotësuar nga persona të tjerë, që nënkupton ekzistencën e vështirësive. Pra, ne nuk bëjmë akt ekspertimi për firmat,

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

ne përpiqemi të kuptojmë ngjarjen dhe në ngjarje na është thënë që ka ndodhur kjo gjë dhe ju nuk e kontestoni faktin që ka ndodhur kjo gjë.

Z. E. Shabani: Ne kontestojmë dorëzimin e kartave. Kemi një procesverbal.

Z. I. Rusmali: Të lutem!

Z. E. Shabani: Dakord, por të paktën mos thoni që nuk e kontestojmë.

Z. I. Rusmali: Me datën kur keni çuar dokumentin, e keni çuar bashkë me karta identiteti. Ai është një procesverbal i marrjes në dorëzim të dokumentacionit.

Z. E. Shabani: Po, ka një arsye pse është procesverbal.

Z. I. Rusmali: Të lutem, e di unë arsyen. Arsyeja është që ata, kur marrin në dorëzim, përpilojnë listën e dokumenteve. Ata nuk miratojnë dokumentet.

Z. E. Shabani: Nuk i miratojnë.

Z. I. Rusmali: Procesi i shqyrtimit dhe miratimit vjen më pas. Pra, ai dokument nuk thotë asnjë gjë në raport me shqetësimin që kemi bashkërisht, kanë qenë kartat e identitetet brenda apo nuk kanë qenë?

Z. E. Shabani: Duhet ta thoshte. Zoti Rusmali, kemi vërejtjet ku mund të shënohet mungojnë karta e identitetit.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. I. Rusmali: Ju lutem, marrja në dorëzim është marrja në dorëzim e paketës, nëse ti i thua: këtu ke listat me kartat e identitetit, ai thotë çek.

Z. E. Shabani: Ai i shikon.

Z. I. Rusmali: Por ai nuk e vlerëson gjënë.

Z. E. Shabani: Ai vlerëson a ka karta apo jo.

Z. I. Rusmali: Ju lutem, vlerësimin komisioni e bën në procedurë shqyrtimit të dokumentacionit. Po të shohësh procesverbalin, procedura e shqyrtimit vjen më pas për të gjitha subjektet. Ky është rregulli. Kështu që nuk ka nevojë të më tundësh një dokument, të cilin ne e dimë shumë mirë se çfarë është. Ne duam të verifikojmë faktin. A ka pasur mungesë, siç thotë procesverbali, që i është komunikuar përfaqësuesit të palës që të mungojnë kartat e identitetit, të lutem, deri në orën 18, apo 16 të ditës së nesërme të na plotësosh me karta identiteti. A ka ndodhur ky fakt?

Z. E. Shabani: Jo, nuk ka asnjë provë të kundërt. Ndërkohë...

Z. I. Rusmali: Kush ishte përfaqësuesi i subjektit? A ka qenë vetë kandidati? A ka ndodhur ky fakt?

Z. E. Shabani: Jo.

Z. K. Garo: Jo.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. E. Shabani: Jo, pra dhe ky pretendim. E diskutojmë kot tani, se ky është proces ligjor, në një proces ligjor ne paraqesim faktet.

Z. I. Rusmali: Ju dhatë përgjigjen dhe përgjigjja u regjistrua. Mbyllet këtu.

Z. E. Shabani: Dakord.

Z. I. Rusmali: Tani, a mund të thërrasim ne si dëshmitar përfaqësuesin e KQZ-së që ka qenë prezent të na e konfirmojë ose të na e mohojë ai gjënë?

Z. E. Çefa: Zoti sekretar i Përgjithshëm, u parashtrua nga palët që është dërguar përfaqësuesi i KQZ-së në KZAZ. A mund të na e konfirmoni këtë fakt dhe të na jepni emrin e personit?

Z. Y. Merkaç: Atëherë ,një person që është trajner i KZA-së, është emëruar nga KQZ-ja si trajner, ka qenë prezent në momentin që është bërë dorëzimi i dokumentacionit. Tani, faktet i ka kërkuar KZAZ-ja apo i dërguar ne këtë nuk mund ta them për momentin.

Z. E. Çefa: E kuptova.

Z. E. Shabani: A mund të them diçka që lidhet me këtë pretendim?

Z. E. Çefa: Ju lutem, një sekondë, do të flasim sa të duam, nuk ka problem, por jemi proceduralisht në një diskutim tjetër me kolegët. Atëherë, KAS-i konsultohet

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

në vend dhe vendos që të dëgjojë shpjegimet e zotit Arjan Gjini lidhur me çështjen në fjalë. Zoti Gjini afrojuni te një mikrofon!

Z. L. Braho: Për efekt procesverbali unë dua të deklarohej që edhe që zoti Gjini gjatë debatit mes palëve ka qenë i pranishëm në sallë.

Z. I. Rusmali: Zoti Gjini, a mund të na e tregoni ju historinë e datës 17?

Z. A. Gjini: Faleminderit! Unë jam Arjan Gjini, me profesion jurist dhe kam një eksperiencë të gjatë në procesin e zgjedhjeve, por dëshiroj të saktësoj, të nderuar zotërinj, që unë nuk kam qenë prezent në datën 17, por kam qenë prezent në datën 18 në Komisionin Zonal. Në datën 28 gjatë procesit të zhvillimit të verifikimit të firmave dhe gjatë të gjithë kohës tjetër kam qenë në KZAZ-në në Dropull, por jo në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Z. I. Rusmali: Na thuaj çfarë ke vënë re?

Z. A. Gjini: Pasi kam shkuar me kërkesën e Komisionit Zonal të Zonës Administrative nr. 82, dhe konsultave më Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Tiranë, kam shkuar në KZAZ-në në Dropull. Pasi kam shkuar aty dhe jam konsultuar me komisionarët, si dhe me dokumentacionin përkatës kam verifikuar që Partia Lëvizja e Legalitetit nuk kishte të nënshkruar një vulë në listën e kandidatëve të dorëzimit të dokumenteve. Dhe lista e subjektit të Nismës Thurje, kam konstatuar që nuk ka pasur lista shoqëruese, fotokopje dhe kartat e identitetit të nënshkruara. Këtë ia kam vënë në dijeni Komisionit Zonal dhe iu kam thënë që a kanë mbajtur një dokumentacion përkatës. Më thanë që ishin në komunikim me përfaqësuesit e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

subjektit “Nisma Thurje” që presin të na plotësojnë dokumentacionin dhe në momentin e deklarimit në orën 18:00 që ka qenë e nënshkruar në procesverbal i kemi bërë me dije, më treguan komisionerët, që të plotësojnë kartat e identitetit me nënshkrime, sipas parashikimeve të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, i gjendur edhe përjashta subjektit të KQAZ-së, ka pasur disa qytetarë që më kanë kontaktuar dhe më kanë thënë që nuk jemi nënshkruar në këtë listë. Atëherë, nga KZAZ-ja, në prezencën time, i kam thënë kryetarit dhe anëtarëve të kontaktojnë me Nismën Thurje të plotësojë dokumentacionin para se të kalonin...A mund të vazhdoj me rrjedhën time?

Z. E. Çefa: Po

Z. A. Gjini: Më kanë thënë që kanë kontaktuar. Kam filluar më subjektet elektorale ka ardhur konstatimi te prezenca e kandidatëve dhe verifikimit të listave, ligji thotë në seancë të hapur. I kam kërkuar kryetarit dhe anëtarëve: a kemi përfaqësues të subjekteve politike të akredituara në Komisionin Zonal Zgjedhor? Jo më thanë. Atëherë, unë e mora të mirëqenë që kjo seancë publike është e hapur, sepse mbledhjet e Komisionit Zonal janë të hapura. Pra, konsiderohen në bindjen time që për derisa nuk ka përfaqësues të subjekteve politike që të monitorojë apo vëzhgues të pavarur, nuk dita një mjet tjetër ligjor, se cila kjo seancë mund të konsiderohej publike. Ia kam bërë të qartë anëtarëve të komisionit që ky është një procesverbal një procedurë administrative dhe çdo telefonatë do të regjistrohet dhe do të verifikohet qartazi dhe do të shënohet në procesverbal dhe asnjë gjë tjetër nuk mund të tjetërsohet në prezencën time. Janë telefonuar subjektet për të ruajtur kuotën. Një numër ka qenë në korrespondencë 4 herë, janë bërë shënimet përkatëse. Ka kaluar ora 18:00, i kam bërë thirrje kryetarit të komisionit në prezencën time të telefonojë

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

subjektin. E ka telefonuar, por nuk kam parë numrin e telefonit, më ka thënë që ma mbylli, i kam thënë që dërgo mesazh se jemi duke i pritur. Kam qëndruar gjatë të gjithë kohës deri në orën 21:00. Për arsye të lodhjes së ditës jam larguar nga kjo mbledhje. E kam raportuar në Tiranë, i nderuar zotëri, është raportuar me shkrim kjo situatë që atë ditë.

Z. I. Rusmali: Ju, kryetar, e konfirmoni këtë rrëfim të personit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e konfirmoni?

Z. E. Shabani: Po.

Z. L. Braho: Një minutë se kam një pyetje: A mund të na sqarojë dëshmitari pozicionin që ka në raport me KZAZ-në dhe KQZ-në dhe çfarë kompetencash ka sipas ligjit dhe aktit normativ?

Z. A. Gjini: Kjo zotëri nuk është një pyetje që mund të më drejtohet mua, sidomos nga pozicioni që ju keni. Ndërsa për sa i përket..

Z. L. Braho: Ju lutem, pyetjet i bëj unë dhe ju jeni në cilësinë e dëshmitarit dhe do t'i përgjigjesh pyetjes sime. Se çfarë pyetjesh do të bëj, unë nuk i cakton ti, kështu që përgjigju pyetjes.

Z. A. Gjini: Faleminderit! E tërheq atë që thashë më parë. Kompetencat e monitoruesit dhe trajnerit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë në dispozitat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe në aktet që ka nxjerrë Rregullatori i

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kam qenë korrekt në atë perceptim. Kam një përvojë të gjatë dhe kam qenë tejet korrekt. Kaq mund të themi.

Z. L. Braho: Prapë nuk e kuptova se çfarë m'u përgjigje.

Z. A. Gjini: Brenda rregulloreve që ka miratuar Komisioni Rregullator i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kanë qenë brenda ato kompetenca.

Z. L. Braho: Ti nuk mund të thuash se çfarë kompetencash ke? Pse ke shkuar? Pra, të na e përshkruash të gjithë procedurën që është ndjekur atë ditë dhe që je larguar nga mbledhja pa mbaruar mbledhja? Pra, cili ishte roli yt që ke takuar dhe disa nënshkrues jashtë KZAZ-së dhe më pas ke marrë pjesë në mbledhjen e KZAZ-së e të tjera. unë dua të di kompetencat e tua.

Z. A. Gjini: E përsëris, që pasi jam kontaktuar nga kryetari i komisionit pas informacionit që na kërkohet online harrova të them edhe këtë që në momentin e parë si trajnues dhe monitorues ju kemi kërkuar komisioneve që të verifikojnë dokumentacionin dhe kur e kanë të pasaktë të mos pranohet fare dokumentacioni. Në momentin e fundit, rreth orës 17:00 - 18:00 na është njoftuar në grup që t'ua kalojmë komisioneve zonale, që të pranohen dokumente edhe pa qenë të plota. Pasi kam kërkuar ndihmë nga ata, jam kontaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga drejtori përkatës, kam shkuar për të ofruar asistencë teknike dhe ligjore. Ky ka qenë e vetmi objeksion, nuk kam kontaktuar me askënd. Aty kanë ardhur njerëz të tjerë, 1 ose 2 persona, dhe më kanë thënë: "Shiko, se listat nuk janë të sakta" dhe këtë e kam thënë në procesverbal, në mbledhje. Dakord, thjesht kam asistuar në një

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

procedurë, nuk kam kryer asnjë lloj veprimi, përveçse kam asistuar dhe kam insistuar që të lajmërohet “Nisma Thurje”, të jetë prezente dhe ua kam bërë të qartë që nëse dikush ka persona, lista e kandidatit do të regjistrohet, sepse ka patur gjatë gjithë ditës, jam ankuar, nga kryetari, që kam patur shantazh. Thjesht, ka qenë integriteti im profesional, përveç pagesës, që është shumë e ulët. Këtu jam për të kryer një kërkim shkencor, që do të më duhet ta botoj pas kësaj pune që kryej këtu.

Z. I. Rusmali: Mirë, për konstatimet, pra ka mangësi, ka probleme, ka ku di unë, thatë që keni komunikuar me KQZ-së, kë keni informuar në KQZ?

Z. A. Gjini: Ne dërgojmë një raport me shkrim, të nderuar zotërinj, dhe e kam paraqitur në atë raport me shkrim, në raportin që bën raporterit, ne paguhemi për këtë, kemi një raport monitorimi, ka patur dokumentacion dhe është dërguar në mënyrë *online* në atë orë, sepse data, ora janë përcaktuar që në atë moment.

Z. I. Rusmali: KQZ-ja mund të na vërë një kopje të këtij raporti në dispozicion? Dakord.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera?

Z. L. Braho: Një pyetje për anëtarët e KZAZ-së. Mbeti ende pa u sqaruar pjesa e verifikimit të listave janë apo s’janë zgjedhës të Bashkisë së Dropullit, por pyetja tjetër që kam unë është: ku jeni bazuar që keni ndjekur këtë procedurën me telefonata bazuar te lista? Në çfarë neni të Kodi Zgjedhor thuhet kjo? Sepse në qoftë se i referoheni nenit 71, pikës 3 thuhet: “Verifikimi, nënshkrimi për zgjedhjet për Kuvendin kryhen nga administrata e KQZ-së, për zgjedhjet e organit të qeverisjes

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

vendore kryhet nga KZAZ-të përkatëse, duke verifikuar 5% të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit”. Këtë nuk e kishit bërë, se këtë e kishit bërë me telefona, nuk e kishit bërë...

Z. G. Dushi: Kjo është bërë me telefona në mënyrë të hapur duke qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i KQZ-së. Po në radhë të parë me telefon e pyesnin: nga je? Nga Gjirokastra. Po, pra nga Gjirokastra, thotë. Nga je? Nga Saranda.

Z. L. Braho: Dakord. Faleminderit! Jam i qartë.

Z. G. Dushi: Për të shtuar dhe diçka tjetër, se në listën e zgjedhësve është dhe një që dje ishte, ndjesë pastë, dhe varrimi i tij.

Z. K. Garo: Mos e përmend atë, se është kushëriri im dhe ka vdekur në datën 28. Turp të kesh!

Z. L. Braho: Pra, ju thoni që ta tërheqim nga nënshkrimi edhe atë.
(Diskutim pa mikrofon)

Znj. K. Zhako: Çdo gjë që është bërë në KZAZ atë ditë, është bërë midis nesh duke rënë dakord, sepse ne nuk kemi jurist. Në KZAZ nuk ka jurist, janë vetëm 4 anëtarë.

Z. E. Shabani: Atëherë Kodi Zgjedhor, neni 73, pika 2, i jep mundësinë, madje e detyron KZAZ-në që të njoftojë subjektet për të plotësuar dokumentacionin, dhe thotë që ky dokumentacion duhet dorëzuar deri 42 ditë para zgjedhjeve, që i bie dita

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

e premtë. Një kopje e këtij dokumentacioni është depozituar në KQZ para këtij afati. Pra, edhe sikur të ekzistonte ky pretendim, dokumentacioni është dorëzuar i plotë në KQZ, një kopje të të cilit e kini ju. Ndërkohë, unë besoj si jurist që komunikimet bëhen me shkrim, me akte. Unë besoj që ky procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit ka vetëm 1 arsye pse bëhet, ka vetëm 1 arsye pse nënshkruhet nga marrësi i saj: për të verifikuar që dokumentacioni që është depozituar, është depozituar apo jo. Pika e parë thotë: “Formular, për mbledhjen, nënshkrimin e zgjedhësve për mbështetjen e kandidatit”. Ai që e ka hartuar këtë formular, nuk ka vendosur një pikë tjetër për kartat. Pra, nënkuptohet që vetëm nëse subjekti ka sjellë nënshkrime të shoqëruara me karta, zoti Gligor Dushi do të nënshkruante, në të kundërt, do ta linte bosh këtë. Ka një arsye pse nënshkruhet kjo, për të verifikuar pikërisht këtë pretendim. E dyta, meqë ju sollët dëshmitarë, atëherë unë kërkoj që të vijë dëshmitar Spiro Toli, i cili ka udhëtuar me makinë me kandidatin Kosta Garo dhe ka depozituar dokumentet. Gjithashtu, ftoj të thirret dëshmitar zoti Panajot Soko, i cili ka folur atë ditë me Kosta Garon, dhe Kosta Garo i ka konfirmuar që i ka depozituar kartat e nevojshme. Gjithashtu, këtu kemi të bëjmë me një situatë ku ka 2 pretendime. Pretendimi i parë është që dokumentet nuk janë dorëzuar në kohë, që, siç e thashë, edhe sikur të ishin përpara këtyre kushteve, megjithëse s’kemi asnjë provë për të kundërtën, brenda afatit prej 42 ditësh, para ditës së zgjedhjeve sipas Kodit Zgjedhor, një kopje ka ardhur këtu në KQZ. Pra, nuk ka pasur interes KZAZ-ja për të plotësuar dokumentacionin. I vetmi interes i KZAZ-së ka qenë për të penguar garimin e Kosta Garos, i cili ka dhënë shtatë variante. Varianti i parë, ishte kjo nuk është parti parlamentare. Varianti i dytë, ishte nuk ke grup themeltar, dhe mbasi mbaruar me këto ishte varianti i tretë: s’ke kartat. Mbasi mbaroi variantin e kartave doli më pretendimin se këta nuk janë banorë të Bashkisë së Dropullit, dhe unë po i kthehem prapë kësaj pike dhe kërkoj të më jepen, të na vihen në dispozicion

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

publikisht listat e atyre nënshkruesve, të cilët nuk rezultojnë në listën e zgjedhësve të Bashkisë së Dropullit. Pra, pretendimet, siç e shikoni, janë të pabazuara, sepse, në fakt, problemi këtu nuk është zbatimi i ligjit, qëllimi këtu nuk është garantimi i ligjit. Qëllimi është pengimi i pjesëmarrjes së Kosta Garos në zgjedhje, sepse është shumë e qartë që këtu pjesëmarrja e Kosta Garos në zgjedhje rrezikon qëndrimin në krye të bashkisë së përfaqësuesit të Partisë Socialiste, parti e cila kontrollon dhe KZAZ-në.

Z. L. Braho: Faleminderit! Po.

Z. I. Rusmali: Mund të bëj një pyetje?

Z. L. Braho: Po, patjetër.

Z. I. Rusmali: Për nënkryetarin e komisionit: ju dispononi listë të zgjedhësve për bashkinë tuaj? Nuk e keni akoma këtë listë. Mundësinë e aksesit në faqen e KQZ-së për të verifikuar listën e keni pasur?

Z. E. Çefa: Me mikrofon, ju lutem, kryetar!

Z. G. Dushi: Jo, nuk kemi patur kurrë lista zgjedhore, por verifikimi është bërë, dihet qartë nëpërmjet...

Z. I. Rusmali: Nëpërmjet telefonit.

Z. G. Dushi: Ne i njohim të gjithë, kush është e kush nuk është.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. I. Rusmali: Këtë e thatë dhe ne e dëgjuam. Zoti Merkaj, se ne s'jemi familjarë me listën, në qoftë se futemi te faqja e KQZ-së, tani nuk punon dhe nuk them dot gjë, po në qoftë se futemi te faqja e KQZ-së dhe kërkojmë të verifikojmë identitetin, kërkojmë të verifikojmë të dhënat tona personale, na e jep aksesin lista pa e vënë atësinë? Jo. Domethënë, pa pasur atësinë, nuk mund të bëhet verifikimi, nëpërmjet listës kombëtare që është në KQZ.

Z. E. Çefa: Kishit diçka për të thënë?

Z. G. Dushi: Kisha për listën, domethënë ne vepruam jo në mënyrë juridike, por në atë njohjet që kemi. Aty kemi persona që janë ushtarë, kemi persona të ndryshëm që nuk firmosin dot, këto doja t'ju thosha.

Z. E. Çefa: Dakord! Faleminderit!

Z. L. Braho: Pra, ju thoni që në varësi të anëtarëve të KZAZ-së, pra kush është anëtar i KZAZ-së, ashtu bëhet edhe verifikimi i listës.

Z. G. Dushi: Jo, absolutisht, jo, në konsulencë të plotë me përfaqësuesin e KQZ-së kemi vepruar.

Z. L. Braho: Përfaqësuesi ishte dëshmitari.

Z. G. Dushi: Po.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. I. Rusmali: Këta emrat që keni marrë për të verifikuar, ju thatë e njihni njeri - tjetrin atje, dhe thatë pak më përpara që dilnin njerëz nga Saranda, ku di unë, ju zgjodhët emra personash që nuk i njihnit, apo të gjithë 17 emrat apo sa janë, i njihni dhe i dini që s'janë banorë?

Z. G. Dushi: Ne i kemi telefonuar në mënyrë rastësore këta persona. Tani i njohim apo nuk i njohim është, pastaj hyn te pjesa personale.

Z. I. Rusmali: Dakord, te pjesa personale, këta 17 persona i njihni të gjithë, apo kini midis tyre dhe që nuk i njihni?

Përfaqësuesi i KZAZ-së: Pothuajse i njohim njerëzit 100%.

Z. I. Rusmali: Dakord.

Z. L. Braho: Po rastësinë si e kini përcaktuar, keni pas ndonjë formulë, keni hedhur ndonjë short, si e keni bërë rastësore? Apo secili anëtar i KZAZ-së ka zgjedhur 3 emra dhe i kini arritur? Pra, si është bërë rastësia, se në dijeninë time, KQZ-ja s'ka ndonjë rregull për këto.

Z. G. Dushi: Filluan te një faqe, pastaj ju e dini vetë si bëhen këto. Në mënyrë rastësore nga 1 vajtëm te 100 te 200 u kthyem prapë.

Z. E. Shabani: Ata kanë hyrë tek të afërmit e vdekur, ju mendoni rastësore, e kanë parë nga fillimi deri në fund.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. L. Braho: Zoti Shabani. Kam një pyetje për Yllin.

Z. E. Shabani: Po, pra po, po ai e di që ka vdekur, imagjinoje...

Z. I. Rusmali: Merr mikrofonin për të hedhur mjegull, i afërmi ishte gjallë, kur kanë bërë verifikimin, nuk ishte i vdekur.

Z. E. Shabani: Ai është në dijeni që edhe ky i afërmi i gjallë ka vdekur dhe ju mendoni realisht se ka verifikuar vetëm 10 veta?!

Z. K. Bele: Kjo provon atë, megjithatë këto ndërhyrjet për të bërë debate dhe ironi nuk i shkojnë kësaj seance, se nuk jemi te Çani këtu.

Z. L. Braho: Ylli, çfarë akti normativ ka për verifikimin e firmave?

Z. Y. Merkaj: Vetëm udhëzimi nr. 1 i Komisionerit.

Z. L. Braho: Ai është akt normativ.

Z. Y. Merkaj: Udhëzimi nuk e rregullon këtë.

Z. L. Braho: Nuk e rregullon.

Z. Y. Merkaj: Mënyrën se si përcaktohet përzgjedhja rastësore.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. L. Braho: Në dijeninë time aktet normative i nxjerr rregullatori, po rregullatori nuk ka ndonjë akt për verifikimin e nënshkrimeve. Faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. E. Çefa: Faleminderit, unë besoj që situata u sqarua!

Z. E. Shabani: Të lutem, kam diçka të fundit.

Z. E. Çefa: Zoti Shabani, do t’jua jap fjalën për konkluzionet përfundimtare, ku dëshiroj që të jeni sa më konciz, sepse e kuptuam situatën praktikisht, kështu që tani mund të kalojmë në atë fazë. Shkurtimisht, konkluzionet përfundimtare dhe çfarë kërkonte nga KAS-i.

Z. E. Shabani: Atëherë, në këtë seancë pamë që i vetmi dëshmitar që sillet si provë, ndërkohë që ke një procesverbal që vërteton të kundërtën, ndërkohë që nuk ke komunikim juridik, pra, ose komunikim zyrtar të verifikuar juridikisht, kemi 1 dëshmitar, i cili e nis fjalinë duke thënë: “Unë nuk kam qenë prezent kur u depozitua dokumentacioni”. Pra, në këtë pikë qartazi e vetmja gjë që e verifikon nëse është dorëzuar apo jo dokumentacioni, është ky procesverbal ku nuk ka asnjë vërejtje për mungesë dokumentacioni. Ky ishte pretendimi i parë. E njëjta gjë, edhe sikur të kishte nevojë për plotësim dokumentacioni, Kodi Zgjedhor e ka parashikuar edhe këtë rast, dhe ka vendosur një aftat brenda 42 ditëve para ditës së zgjedhjeve për plotësimin e dokumentacionit. Nuk ka pasur pretendime të tilla, ndërkohë një kopje e kini aty. Përderisa kartat janë tani, përderisa kartat ka qenë 42 ditë para, kanë qenë edhe 45 ditë para. Pretendimi i dytë ishte që është bërë verifikimi dhe nga ky verifikim është gjetur që këta nuk janë zgjedhës të Bashkisë së Dropullit, ndërkohë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

u tha se ne nuk e kemi bërë juridikisht, ne nuk e kemi listën e zgjedhësve, por e kemi parë që këta nuk janë zgjedhës. Tani unë prapë kam kërkesën që e nisa në fillim, ju lutem, në procesverbal ju duhet të keni emrat e 16 apo 17 vetave, për të cilët ju pretendomi se nuk janë zgjedhës në Bashkinë e Dropullit. Pa depozituar një listë të tillë, edhe ju s'keni mundësi të merrni një vendim, bazuar mbi këtë pretendim. Unë kërkoj sërish, së fundmi, edhe një herë listën e 17 nënshkruesve, për të cilët pretendohet se nuk janë zgjedhës në Bashkinë e Dropullit, në mënyrë që edhe ne, edhe ju ta verifikojmë këtë pretendim.

Z. E. Çefa: Atëherë, ishim në konkluzione, përfundoje!

Z. E. Shabani: Atëherë, ajo që kërkoj nga KAS-i është: të garantojë të drejtën kushtetuese të kandidatit Kosta Garo për të marrë pjesë në zgjedhje, sepse, duke mos bërë këtë, ju do të krijoni një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm. Po ju kujtoj edhe një herë se Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia e Lirisë kanë mundësi të regjistrohen në zgjedhje.

Z. E. Çefa: Kërkova qëndrimin juridik, tani zoti Shabani, të lutem, mos përfiton!

Z. E. Shabani: Qëndrimi juridik është precedenti, pra, çdo njeri që nesër do të paraqesë firma me pretendime të tilla, mund të pengohet për t'u regjistruar në zgjedhje. Pra, Kodi Zgjedhor dhe ky institucion janë këtu për të garantuar të drejtën kushtetuese për të marrë pjesë në zgjedhje, jo për ta penguar këtë të drejtë. Me këto precedentë ju do të pengoni, nesër, pasnesër do të krijoni një mekanizëm ku ekstra çdo pretendent jashtë sistemit nuk do të lejohet të marrë pjesë në zgjedhje, që është precedent i rrezikshëm për demokracinë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë përfaqësuesi i KZAZ-së shkurtimisht qëndrimin përfundimtar.

Z. G. Dushi: I gjithë procesi që ka kryer AKZM-ja, KZAZ-ja nr. 82 ishte proces i rregullt, proces i bazuar në Kodin Zgjedhor dhe kam kërkuar ndihmë, të sqaroj edhe një herë, të KQZ-së, ndihmën juridike, meqenëse ne ngelëm 4 veta pa sekretar. Procesi është ky: që lista e zgjedhësve jo vetëm që ka njerëz që janë jashtë listës, jashtë banimit, por ka njerëz të cilët janë në Athinë dhe kanë firmosur njerëz tjerë për llogari të tyre këtu. Të verifikohen këto, kemi deklarata që janë bërë që njerëz që janë këtu kanë firmosur kot për njerëz që janë në Athinë, dhe kartat e identitetit që keni ju atje, firmat e atyre janë firmosur këtu nga tjetër person dhe listat zgjedhore janë firmosur nga tjetër person. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Dakord. Ju faleminderit! Atëherë, ne do të tërhiqemi pak për ta diskutuar dhe për të shpallur vendimin.

Z. G. Dushi: Mund t'i japim edhe këto deklaratat?

Z. E. Çefa: Tani në këtë fazë e ezauruam proceduralisht atë moment, kryetar. Ne do të tërhiqemi për vendimin. Do t'ju lajmërojmë, besoj për gjysmë ore, ndoshta. Ndërkohë që KQZ-ja bën gati dokumentet që iu kërkuan gjatë seancës. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.04.2023*

*Rifillon
Ora 13.56*

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS-i, pasi e diskutoi çështjen në tërësi me shumicën e votave vendosi: Rrëzimin e ankimit të subjektit zgjedhor “Nisma Thurje” dhe të kandidatit për kryetar të Bashkisë së Dropullit, zotit Kosta Garo. Lënien në fuqi të vendimit nr. 10, datë 23 mars 2023, të KZAZ-së nr. 82 në Bashkinë e Dropullit, Gjirokastër. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 43

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

03.04.2023

Ora 14:15

RENDI I DITËS

“Shorti për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr.45, ankues Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 3 prill 2023 ora 14:15 do të zhvillohet procedura e caktimit të shortit për caktimin e relatorit kërkesa ankimore numër 45 me ankues Aleanca Progresiste LZHK ku objekti ankimit, kundërshtimi i vendimit të KZAZ-së 25 Përrenjas me numër 20 datë 30.03.2023 ora 21:05 e cila ka vendosur regjistrimin e listës së kandidatëve të LZHK-së për Bashkinë Përrenjas. Procedura e shortit referohet nenit 14 të rregullores së KAS-it për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin është shkruar kërkesa ankimore numër 45, 4 shiritat e tjera janë të bardha dhe pa shënime të cilat pasi palosen nga një përfaqësues i KQZ-së, vendosen në gogla me peshë, formë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente. Pasi vendosen në një enë transparente përzihen nga një përfaqësues i KQZ-së dhe tërhiqen goglat nga anaëtarët e KAS-it. Duke qënë se anaëtarët e KAS-it janë të pranishëm në seancë kanë autorizuar përfaqësuesin e KQZ-së t'i tërheqi goglat në emër dhe për llogari të tyre. Atëherë do të vazhdojmë procedurën duke filluar me rendin alfabetik rritës nga emri i parë zoti Ervin Lako.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2023*

-Tërhiqet gogla - Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - kërkesa ankimore numër 45.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit kërkesa ankimore numër 45 është caktuar relator zoti Ervin Lako, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

